

**Antonio Jovanovski
Aleksandar Tërpkovski**



**MUNDËSITË PËR TË RINJTË NË KOHË
TË NDRYSHIMEVE KLIMATIKE DHE
TË TRANZICIONIT TË ENERGJISË**

IMPRESUM

Titulli:

*Mundësitë për të rinjtë në kohë
të ndryshimeve klimatike dhe tranzicionit të energjisë*

Botues:

Konrad-Adenauer-Stiftung, Maqedoni

Autor:

Antonio Jovanovski, Go Green Shkup

Asistent i autorit:

Aleksandar Tërpkovski, Go Green Shkup

Përktheu nga anglishtja:

Blerina Starova-Zllatku

Bashkërenditje dhe redaktimi i fundit:

Daniella Popovska, Konrad-Adenauer-Stiftung, Maqedoni

Përgatitja teknike dhe shtypja:

Vinsent Grafika

Tirazhi:

200 kopje

Mund të shkarkoni publikimin falas në:

<http://www.kas.de/mazedonien/en/publications/>

<http://www.gogreen.mk/>

Shënim:

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë qëndrime personale të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Konrad-Adenauer-Stiftung. Njëkohësisht Fondacioni Konrad Adenauer nuk merr përgjegjësinë për gabimet eventuale të përkthimit nga anglishtja në shqip.



**MUNDËSITË PËR TË RINJTË
NË KOHË TË NDRYSHIMEVE**

**KLIMATIKE DHE TË
TRANZICIONIT TË ENERGJISË**

Autor: Antonio Jovanovski
Asistent: Aleksandar Tërpkovski

prill 2015



PËRMBAJTJA:

Hyrje	3
Metodologjia	5
Përmbledhja	5
1. Ndryshimet klimatike dhe tranzicioni i energjisë	7
2. Ballkani Perëndimor – Klima, energjia dhe zhvillimi i të rinjve	9
2.1 Të rinjtë	10
3. Klima dhe energjia – rasti i Maqedonisë	11
3.1 Statusi i të rinjve në Maqedoni	12
4. Klima dhe energjia – rasti i Serbisë	14
4.1 Statusi i të rinjve në Serbi	16
5. Klima dhe energjia – rasti i Kosovës	17
5.1 Statusi i të rinjve në Kosovë	19
6. Klima dhe energjia – rasti i Kroacisë	21
6.1 Statusi i të rinjve në Kroaci	22
7. Konkluzionet / mbi klimën dhe energjinë	24
7.1 Konkluzionet lidhur me të rinjtë në Ballkanin Perëndimor	26
8. Rekomandimet	27
Shtojca I	30
Shtojca II	37
Për autorët	46

HYRJE

Lexues të nderuar,

Politika e ndryshimeve klimatike dhe në përgjithësi, zhvillimi i qëndrueshëm janë çështje që padyshim kërkojnë një qasje ndërkombëtare. Ato duhet të shihen si një sfidë globale dhe duhet të trajtohen me përfshirjen dhe bashkëpunimin e të gjitha vendeve dhe rajoneve në botë. Ato nuk janë objekt i vetëm një politike kombëtare, pavarësisht nëse bëhet fjalë për një vend të BE-së, për një nga vendet në zhvillim, vendet në tranzicion, etj. – pavarësisht se në cilin kontinent gjenden, ose çfarë formimi politik kanë. Çështja e ndryshimeve klimatike dhe e energjisë janë çështje që kanë të bëjnë me sigurinë, migrimin, shpërndarjen e resurseve, si dhe paraqet një çështje globale ekonomike. Mëtej, për t'iu qasur këtyre çështjeve në mënyrën më përkatëse, duhet zhvilluar politika dhe strategji globale.

Duke qenë një fondacion politik, Fondacioni Konrad Adenauer i është përkushtuar fuqishëm mbështetjes së projekteve të zhvillimit të qëndrueshëm në botë. Që nga viti 2010, ne aktivisht kemi mbështetur projekte në këtë fushë edhe në Maqedoni. Qëllimi ynë është të intensifikojmë debatet mbi çështjet lidhur me ambientin jetësor, ndryshimet klimatike dhe politikës së energjisë, si dhe të inkurajojmë këmbimin e përvojave midis Gjermanisë dhe Maqedonisë, por edhe midis vendeve në rajon.

Ndërkaq, fuqishëm mbështesim përfshirjen e të rinjve në projekte të këtilla, pasi besojmë se brezat e rinj duhet të luajnë rolin qendror në sjelljen e ideve të freskëta në të gjitha fazat e zhvillimit të qëndrueshëm: nga biznesi në komunitet e deri në hartim të politikave.

OJQ-ja ekologjike "Go Green" dhe "Konrad-Adenauer-Stiftung" janë partnerë që nga viti 2013, dhe trajtojnë kryesisht çështje të ndryshimeve klimatike dhe të energjisë. Çdo vit ne kemi organizuar shënimin e *Ditës Botërore të Ambientit Jetësor të KB-ve më 5 qershor*, si dhe *Javën e Energjisë së Qëndrueshme të BE-së*, me qëllim ngritja e vetëdijes në mesin e popullatës së re dhe mobilizimi i të rinjve për të ndërmarrë veprime për mbrojtje të ambientit jetësor në komunitetet e tyre lokale.

Si pjesë e bashkëpunimit tonë, kemi organizuar punëtori dhe debate me kryetarë dhe përfaqësues të komunave, ministra dhe ambasadorë,

deputetë, si dhe me institucione të tjera relevante, me qëllim lobimi dhe ndikimi në politikat e energjisë së qëndrueshme dhe ekonomisë së favorshme ndaj klimës. Në të njëjtën kohë, kemi botuar bashkërisht disa publikime të cilat trajtojnë çështje të efikasitetit energjetik përmes riciklimit, mundësive për të rinjtë në kohë të ndryshimeve klimatike dhe tranzicionit të energjisë, etj.

Fusha e fundit e bashkëpunimit është "Punësimi i të rinjve në sektorin e energjisë së pastër" ku, përveç lobimit dhe përfaqësimit për përmirësimin e politikave, organizojmë evente siç janë *Panairi i Energjisë së Pastër*, ku të rinjtë takohen me universitetet dhe kompanitë që ofrojnë mundësi lidhur me energjinë e ripërtërishe dhe me efikasitetin e energjisë. Publikimi "*Mundësitë për të rinjtë në kohë të ndryshimeve klimatike dhe tranzicionit të energjisë*" është gjithashtu pjesë e nismës për frymëzim dhe inkuadrim të të rinjve për të studiuar dhe punuar në këtë fushë. Me këtë rast, dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për të dy ekipet për përkushtimin e tyre në këtë projekt, sidomos bashkëpunonjësit tanë nga "Go Green", si dhe Daniella Popovska nga "Konrad-Adenauer-Stiftung" të cilët dhanë kontributin e vlefshëm në përgatitjen dhe realizimin e këtij publikimi.

Me aktivitetet tona të përbashkëta kemi përfshirë më se 1.000 të rinj dhe mbi 50 komuna. Bashkëpunimi jonë ka dëshmuar se kombinimi i entuziazmit dhe ideve kreative, si dhe të një partneri të përkushtuar dhe të besueshëm është receta e suksesit dhe impaktit pozitiv në shoqëri.

U gëzohemi projekteve dhe bashkëpunimit tonë të përbashkët në të ardhmen dhe u dëshirojmë lexim të këndshëm dhe interesant.

Me respekt,

Johannes D. Rey
Konrad-Adenauer-Stiftung, Maqedoni

Antonio Jovanovski
Go Green Shkup

METODOLOGJIA

Ky dokument u përpilua si rezultat i hulumtimit të literaturës së disponueshme në këtë temë. Gjithashtu u përgatit një sondazh online për të vlerësuar mendimet dhe njohuritë e të rinjve, nga i cili dolën edhe disa konkluzione. Informacione plotësuese janë siguruar nëpërmjet të diskutimeve dhe kontributeve nga partnerë të organizatave të shoqërisë civile nga vendet që janë objekt i këtij dokumenti. Ky studim nuk paraqet një raport shkencor, por është paraparë që të jap një pasqyrë të gjendjes që do t'u mundësojë krijuesve të politikave, opinionistëve, specialistëve dhe jospécialistëve në shoqërinë civile, që të nxisin dialogun lidhur me mënyrat më të mira për trajtimin e ndryshimeve klimatike dhe për krijimin e mundësive që të dalin talentet e rinj të energjisë për ta përsheptuar tranzicionin e energjisë drejt ekonomisë me karbon të ulët. Atje ku është e mundur, do të ofrohen linqe drejt dokumenteve ose instituteve ku mund të gjenden informacione plotësuese.

PËRMBLEDHJA

Ndryshimet klimatike paraqesin një kërcënim të ashpër për zhvillimin e qëndrueshëm të mëtejshëm të shoqërive tona. Tranzicioni drejt zhvillimit me emetim të ulët, si në ekonominë e zhvilluara, ashtu dhe në ato në zhvillim, në nivelin ndërkombëtar është identifikuar si i domosdoshëm për stabilizimin e përqendrimin të gazit serrë, në përputhje me skenarin e rritjes së temperaturës deri në 2 gradë celsius. Për të arritur pakësimin e emetimit, kërkohet kalimi nga karburanti fosil në burimet e ripërtërishme të energjisë. Zvogëlimi i emetimeve të karbonit nga rritja ekonomike në të gjithë sektorët do të shkaktojë çrregullime në industrinë e vendosura dhe do të rrezikojë vendet ekzistuese të punës. Nga ana tjetër, masat e zbutjes dhe të përshtatjes së ndryshimeve klimatike do të krijojnë vende të reja pune, si në sektorët ekzistues, ashtu dhe në sektorët e ri të shoqërisë. Për arsye të rritjes së shpejtë të sektorit të energjisë së ripërtërishme dhe efikasitetit të energjisë, ka mungesë të shkathtësive, dhe mungesë të personave të kualifikuar për ta vazhduar zhvillimin e tij. Industria evropiane çon drejt zhvillimit të teknologjisë globale të energjisë së ripërtërishme dhe punëson 1.5 milionë njerëz, dhe deri në fund të vitit 2020, mund të punësojë dhe 3 milionë njerëz tjerë¹. Masat efektive të efikasitetit të energjisë mund të krijojnë ose të ruajnë rreth 2 milionë vende pune të gjelbra në Evropë².

¹ Komisioni Evropian, viti 2011, Energjia e Ripërtërishme: përparimi drejt qëllimit të vitit 2020.

² Komisioni Evropian, viti 2011, Vlerësimi i ndikimit, shoqëruar me Planin e Efikasitetit Energjetik.

Nga ana tjetër, më se 5 milionë të rinj, në moshë nga 15-24 vjeçare në BE janë të papunë sot.³ Roli i të rinjve në tranzicionin e energjisë, në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe strategjinë e zbutjes së pasojave ka rëndësi shumë të madhe. BE-ja ka vendosur mekanizma për financimin e nismave dhe për inkurajimin dhe inkuadrimit të të rinjve, siç janë *garancia rinore* dhe *iniciativa për punësimin e të rinjve*, të cilat kanë për qëllim rritjen e inkuadrimit dhe punësimit të të rinjve në industritë evropiane. Sido që të jetë, mbetet një hendek i konsiderueshëm midis vendeve me shkallë më të lartë dhe më të ulët të papunësisë tek të rinjtë. Ekziston një hendek nga më se 40 % midis vendeve anëtare, me shkallën më të ulët të papunësisë tek të rinjtë (Gjermania me 7.4% në nëntor të vitit 2014) dhe vendet anëtare me shkallët më të larta, Spanja (51.4%), Greqia (50.6%), Kroacia (44.8%). Nevojitet një brez i ri e kualifikuar për ta lëvizur zhvillimin e ekonomive të gjelbra dhe për ta përsheptuar tranzicionin e energjisë.

Por, cilat janë mundësitë dhe sfidat për të rinjtë në Ballkanin Perëndimor? Me shkallë papunësie tek të rinjtë nga më se 50% dhe ekonomi që bazohen mbi karburante fosile, si do të ndikojnë politikat e BE-së në Ballkanin Perëndimor? Cilët sektorë do të hapin mundësi punësimi? Sa është vetëdija e të rinjve? A janë të interesuar ata për të studiuar dhe punuar në sektorin e energjisë së ripërtërishme dhe atë të efikasitetit të energjisë? Ky dokument ka për qëllim të jap përgjigje në disa nga këto pyetje, duke dhënë një pasqyrë të shkurtër të gjendjes me klimën dhe energjinë, dhe të rolit që luajnë të rinjtë në 4 vendet: Maqedoni, Serbi, Kosovë dhe Kroaci. Si shtojcë është dhënë dhe një listë e universiteteve që ofrojnë studime mbi energjinë e ripërtërishme dhe efikasitetin e energjisë.

Sektorët që janë posaçërisht të ndjeshëm ndaj ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor përfshijnë resurset e ujërave, bujqësinë, biodiversitetin, energjinë, shëndetin njerëzor dhe turizmin. Pjesa më e madhe e emetimit të gazrave serrë vjen nga sektori energjetik, i cili parimisht bazohet mbi centrale elektrike me thëngjill. Hidro dhe biomasa luajnë një rol të rëndësishëm në kombinimin e energjisë së ripërtërishme në këto vende, dhe fatkeqësisht, energjia solare nuk paraqet një prioritet, përkundër potencialit të lartë. Efikasiteti energjetik vështrohet si prioritet dhe ai krijon mundësi punësimi. Të rinjtë janë të interesuar të studiojnë dhe të punojnë në sektorin e energjisë së ripërtërishme, por kryesisht kanë mungesë të informacioneve mbi mundësitë akademike dhe profesionale në këtë fushë.

³ Shqyrtimi i papunësisë tek të rinjtë në BE, janar, viti 2015.

1. NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE TRANZICIONI I ENERGJISË

Aktiviteti njerëzor shkakton ndryshimet klimatike. Rritja e emetimit të gazrave serrë në atmosferën e Tokës, sidomos dyoksid karboni shkaktojnë rritjen e temperaturës globale. Temperatura e rritur shkakton që klima të ndryshojë më shpejtë se zhvillimi i saj i natyrshëm, dhe pasojat për njerëzimin janë potencialisht shkatërruese. Përmbytjet, thatësitat e ashpra, tornadot, humbja e biodiversitetit, viruset dhe sëmundjet bakteriale janë vetëm disa nga pasojat të cilat do të ndryshojnë mënyrën e jetesës së njerëzve sot. Sipas Këshillit Ndërkombëtar të Unionit Shkencor, Programit për Ambient Jetësor të Kombeve të Bashkuara dhe Organizatës Meteorologjike Botërore, për të parandaluar ndikimet më të ashpra të ndryshimeve klimatike, do të duhet ta kufizojmë rritjen globale mesatare të temperaturës deri në 2 gradë celsius deri në fund të shekullit 21, nivel që përputhet me periudhën para-industriale. Ndryshe, do të shohim ndryshime në të vërtetë detit dhe ndryshime ekstreme të motit. Sido që të jetë, nëse vazhdojmë me "punën e zakonshme" dhe lejojmë emetime për ta vazhduar rritjen e shkallës aktuale, ndikimet deri në fund të këtij shekulli janë paraparë të përfshijnë një temperaturë mesatare globale për 2.6 - 4.8 gradë celsius më të lartë se temperatura aktuale⁴.

Për ta ndaluar rritjen e temperaturës mbi 2 gradë celsius, nevojiten ndryshime në shumë aspekte të mënyrës së jetës sot, sidomos në kuptimin e resurseve, dhe akoma më me rëndësi, të energjisë. Furnizimi i tanishëm me energji bazohet parimisht në karburantet fosile, gjegjësisht, thëngjilli, vaji dhe gazi që shkaktojnë pjesën më të madhe të emetimeve të CO₂ në atmosferë⁵. Sfidat me të cilat përballemi bëhen edhe më të mëdha për arsye të rritjes globale të kërkesës për energjisë, të cilat parimisht udhëhiqen nga rritja ekonomike dhe rritja e popullsisë. Stabilizimi i emetimeve në nivele që janë kompatible me 2 gradët celsius botërisht të dakorduar do të thotë transformim themelor i industrisë së energjisë në botë, në rrugën drejt dekarbonizimit të plotë⁶.

Ndryshimet klimatike do të ndikojnë si në ekonomi, ashtu dhe në punësim. Ndryshimet klimatike posaçërisht do të prekin infrastrukturën nga e cila varet pjesa më e madhe e punësimeve. Ka gjasa që energjia, uji, transporti

⁴ Raporti i Pestë i Vlerësimit, Paneli Ndërqeveritar mbi Ndryshimet Klimatike (IPCC), qërshor, viti 2014.

⁵ 81,7% të furnizimit primar të përgjithshëm të energjisë vjen nga karburantet fosil – Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë, Statistika Kryesore Botërore mbi Energjinë, viti 2014.

⁶ Ndërlikimet në sektorin energjetik, Raporti i Pestë i Vlerësimit, IPCC, qërshor, viti 2014.

dhe telekomunikimet të ballafaqohen me çrregullime nga përmbytjet, stuhitë, thatësitat dhe ekstremet e temperaturave. Megjithatë, përpjekjet që bëhen për t'i zbutur ndryshimet klimatike dhe për t'iu përshtatur efekteve të tyre gjithashtu krijojnë mundësi punësimi në sektorët e burimeve të energjisë së ripërtërishme dhe efikasitetit energjetik, reduktimin e emetimeve nga shpyllëzimi dhe degradimi i pyjeve, bio karburantet dhe infrastrukturë fleksibile⁷.

Liderët botëror sivjet do të takohen në Paris për të bërë negociata rreth ndryshimeve klimatike gjatë Konferencës së Palëve në KB. Krerët do të negociojnë një marrëveshje detyruese që vendet të reduktojnë emetimet e gazrave serrë dhe të vendosin një mekanizëm për të financuar tranzicionin e energjisë. Secili vend ka rolin e vet në vënien e synimeve të veta, ndarjen e ngarkesës dhe marrjen përsipër të përgjegjësiive konkrete. Qëndrimet negociatore të prodhuesve dhe konsumatorëve të mëdhenj të energjisë, siç janë SHBA-të, Kina dhe Bashkimi Evropian do të jenë me rëndësi vendimtare për të arritur një marrëveshje të suksesshme në Paris, e cila do të përcaktojë të ardhmen e Planetit Tokë dhe të njerëzimit.

Roli i Bashkimit Evropian, si importues më i madh i energjisë në botë dhe ndotësi i tretë më i madh ka rëndësi parësore në shtytjen e tranzicionit të suksesshëm të energjisë. Kriza Rusi-Ukrainë ka ndikuar në politikat energjetike dhe në "Strategjinë Kornizë për Bashkim Energjetik" të Komisionit Evropian⁸. Pikat kryesore të veprimit në dokumentin e Bashkimit Energjetik kanë të bëjnë me rritjen e gazit dhe diversifikimin e burimeve të veta, por pa përkushtim të qartë ndaj burimeve të energjisë së ripërtërishme si bërthama e sistemit energjetik. Gazi është një karburant fosil "i pastër" dhe shpesh shihet si një element tranzicioni drejt një sistemi të energjisë së ripërtërishëm. Ky zhvillim vë në pyetje angazhimin e vërtetë të BE-së për një ekonomi miqësore ndaj klimës me karbon të ulët. Megjithatë, BE-ja ka ndërmarrë angazhimet më ambicioze në botë për ndryshimin e klimës. Me miratimin e *Kornizës së BE-së mbi Klimën dhe Energjinë për vitin 2030*⁹ më 23 tetor të vitit 2014, BE-ja vendosi 3 objektiva deri në vitin 2030: ta zvogëlojë emetimin e gazrave serrë për të paktën 40%, 27% për pjesën e energjisë së ripërtërishme dhe 27% për përmirësimin e efikasitetit energjetik, në krahasim me nivelet e viteve 90të. Aq më tepër, *Pjesa e Programit – Projekti 2050*¹⁰ i Fondacionit Evropian për Klimë ka për qëllim arritjen e së paku 80% të reduktimit të emetimit të gazrave serrë deri në vitin 2050. Arritja e këtij qëllimi kërkon transformim thelbësor të sistemit energjetik të Evropës. Këto objektiva theksojnë qëndrimin

⁷ Raporti i Pestë i Vlerësimit, Ndryshimet klimatike: Ndërlikimet në punësim, IPCC.

⁸ http://ec.europa.eu/priorities/energy-union/index_en.htm.

⁹ http://ec.europa.eu/clima/news/articles/news_2014102401_en.htm.

¹⁰ <http://www.roadmap2050.eu/project/roadmap-2050>.

e Bashkimit Evropian si një lider botëror në luftën kundër ndryshimeve klimatike, gjë kjo e cila do të mundësojë sigurinë e furnizimeve me energji të BE-së dhe do të reduktojë varësinë nga karburantet fosile të importuar.

2. BALLKANI PERËNDIMOR – KLIMA, ENERGJIA DHE INKUADRIMI I TË RINJVE

Fatkeqësitë natyrore paraqesin një kërcënim të madh për vendet e Evropës Juglindore. Ekonomitë e tyre të brishta janë acaruar edhe më shumë nga përmbytjet, tërmetet, shkarjet e tokës, zjarret pyjore, thatësira, valët e nxehta, stinët e zgjatura të dimrit, dhe stuhitë e breshrit që paraqiten në këto vende. Efektet e këtyre fenomeneve paraqesin një kërcënim të konsiderueshëm për ekonomitë dhe popullatën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë këtu dhe Kroacinë, Maqedoninë, Serbinë dhe Kosovën.

Kroacia klasifikohet si vend i Shtojcës I (ekonomi e industrializuar ose në rritje), sipas Protokollit të Kiotos për targetet detyruese të reduktimit të emetimeve. Maqedonia, Serbia dhe Kosova janë klasifikuar si vende që nuk janë pjesë e Shtojcës I (vende në zhvillim), pa detyrime për reduktimin e emetimeve. Gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor janë pjesë e Traktatit të Bashkësisë Energjetike (ECT), që u nënshkrua në tetor të vitit 2005 nga Bashkimi Evropian dhe nëntë palët nënshkruese (PN). Komuniteti Energjetik u krijua për një periudhë 10-vjeçare, dhe përfundon në korrik të vitit 2016. Komuniteti Energjetik ka për qëllim që legjislati evropian të shtrihet në të gjitha vendet pjesëmarrëse. Me aderimin në Traktatin e Bashkësisë Energjetik, PN-të janë zotuar t'i zbatojnë rregullat përkatëse të BE-së mbi energjinë, ambientin jetësor dhe konkurrencën. Në tetor të vitit 2012, Këshilli i 10-të Ministrorë i Komunitetit Energjetik ra dakord për të zbatuar Direktivën BER¹¹ mbi promovimin e energjisë së ripërtërishme nga Komunitetit Energjetik. Me këtë Direktivë, vendet kanë ndërmarrë detyrimin e përdorimit të energjisë së ripërtërishme, si pjesë e konsumit të tyre të përgjithshëm të energjisë në vitin 2020.

Të katër vendet parimisht prodhojnë energji nga thëngjilli, dhe në vend të dytë është prodhimi i energjisë nga ujërat pra varen nga kushtet hidrologjike. Prodhimi i gazit natyror nuk është aq i zakonshëm për këto vende, pasi në Kroaci dhe Serbi ka pak, ndërsa në Maqedoni dhe Kosovë nuk ka aspak. Elementet kryesore të infrastrukturës energjetike në Ballkanin Perëndimor janë ndërtuar në vitet 60-të dhe 70-të. Mosha dhe lloji i kësaj teknologjie, kombinuar me mirëmbajtjen joadekuate

¹¹ Direktiva BER 2009/28/EC.

në vitet 90-të paraqesin sfida serioze teknike dhe politike¹². Për shkak të mungesës së bashkëpunimit midis këtyre vendeve, mirëmbajtja e furnizimit të brendshëm të energjisë bëhet gjithnjë e më e shtrenjtë. Aq më tepër, vendet kanë nivele të ndryshueshme të varësisë nga importi i energjisë, të furnizimit të plotë primar të energjisë, të miksit të energjisë dhe të volumeve të prodhimit të energjisë brënda vendit.

Kroacia dhe Maqedonia importojnë pothuajse gjysmën e energjisë për shfrytëzimin e tyre të përgjithshëm të energjisë, Serbia importon një të tretën e energjisë, ndërsa Kosova është më së paku e varur nga importet, me vetëm 9%¹³. Kërkesat e energjisë pritet të rriten në dekadat e ardhshme, edhe pse të katër vendet kanë potencial thelbësor në burimet e energjisë së ripërtërishme, të cilët bazojnë të ardhmen e energjisë së tyre mbi karburantet fosile. Energjia e ujit paraqet burim dominues të energjisë së ripërtërishme, madje edhe energjia e erës, ajo solare, e biomasës dhe ajo gjeotermale kanë një potencial të konsiderueshëm. Deri tani, kjo është eksploruar deri në një shkallë shumë të kufizuar nga Kroacia (era) dhe nga Serbia (biomasa).

2.1 Të rinjtë

Të qenit një person i ri në Ballkan ka sfidat e veta. Shkalla mesatare e papunësisë tek të rinjtë është afro 50%. Shumë të rinj në Ballkan përpunohen të zhvillojnë një jetë më të mirë socio-ekonomike jashtë vendeve të tyre. Kjo valë masive e emigrimit të të rinjve në rajon arriti përmasa alarmues përpara se vendet të fillojnë t'i kushtojnë vëmendje serioze këtij problemi. Me krijimin e Strategjive Kombëtare për të Rinjtë dhe Planet e tyre të Veprimit, vendet e rajonit kanë bërë përpjekje për të krijuar një kornizë e cila do të siguronte tejkalimin e vështirësive të të rinjve lidhur me arsimimin, kushtet e jetës dhe mundësitë e punësimit. Të rinjtë përfaqësohen nëpërmjet Këshillat Kombëtare Rinore, organizata ombrellë të organizatave rinore, të cilat duhet, në teori, të bëjnë që zëri i të rinjve të dëgjohet nga institucionet. Një mekanizëm tjetër i inkuadrimit të të rinjve janë këshillat rinore në komunat. Megjithatë, interesat e anëtarëve të këshillave komunal të të rinjve dhe ata të partive politike shpesh bien ndesh, pastaj mungon pjesëmarrja relevante e opinionit publik, dhe kështu vihet në pyetje nëse këshillat rinor lokal përfaqësojnë nevojat e vërteta të të rinjve. Shkallët e larta të papunësisë së të rinjve në rajon prej rreth 50%, kërkojnë një qasje të strukturuar ndaj këtij problemi, gjë kjo e cila do t'i bashkojë institucionet shtetërore, sektorin privat dhe shoqërinë civile, për të siguruar një të ardhme më të mirë për të rinjtë në Ballkan.

¹² Përmbledhje mbi Politikën më të MIRË: PERSPEKTIVAT E MEKANIZMAVE TË BASHKËPUNIMIT BER MIDIS VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR DHE BE-së.

¹³ Deklarata e Sigurisë së Furnizimeve në Kosovë, Prishtinë, korrik, viti 2013.

3. KLIMA DHE ENERGJIA – RASTI I MAQEDONISË

Maqedonia është një vend malor, me lugina, lumenj dhe liqej të thellë. Pyjet mbulojnë rreth 1/3 të sipërfaqes, ndërsa 50% të tokës përdoret për bujqësi. Biodiversiteti është i paçmueshëm, me më se 16,000 specie, nga të cilat 854 janë endemike. Edhe pse vendi mbulon një territor të vogël, ai ka 8 rajone klimatike. Prandaj, pritet që pasojat e ndryshimeve klimatike të ndryshohen konsiderueshëm nëpër tërë vendin, me temperatura mesatare të rritura dhe sasi të kufizuar të ujit, gjë që do të rris gjasat për thatësira, zjarre pyjore dhe valë nxehtësie. Në pjesën veri-perëndimore të vendit, rajonet e ulëta përballen me rrezikun nga ngritja e niveleve të lumenjve. Kushtet e shpeshta të motit ekstrem (përmbytjet, thatësitat, shkarjet e tokës, sëmundjet, etj.) pritet të bëhen edhe më të shpeshta, siç u dëshmuua me përmbytjet e fundit në Maqedoninë Lindore¹⁴. Resurset e ujit do të jetë një nga fushat më të prekura dhe do të vërehet një rënie e dukshme në prodhimet bujqësore, gjegjësisht, prodhimet e domateve, të cilat mund të shënojnë rënie prej 81% dhe prodhimet e mollëve me rënie prej 50% deri në vitin 2050.¹⁵

Burimi më i madh i emetimit të gazrave serrë është sektori energjetik me 73%, vijuar nga bujqësia me 13%, dhe sektorët e mbeturinave dhe të industrisë, me 7%.¹⁶

Sektori energjetik në Maqedoni karakterizohet me prodhimin e energjisë nga termocentralet (me linjit), i cili përbën rreth 66% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë, dhe hidrocentralet, të cilat përbëjnë rreth 34% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë. Gazi shndërrohet në një burim të rëndësishëm të energjisë për vendin. Janë dy opsione në dispozicion kur bie fjala për furnizimin me gaz – njëri është gazi nga Rusia, nëpërmjet të Rrymës Jugore (South Stream), dhe tjetri është gazi nga Azerbajxhani nëpërmjet Gazsjellësit Trans-Adriatik. Qeveria ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Rusinë për Rrymën Jugore, duke lejuar kompanitë të ndërtojnë një gazsjellës që do të kalojë nëpër Maqedoni. Qeveria gjithashtu ka nënshkruar dhe një memorandum më të përgjithshëm bashkëpunimi për energji me Azerbajxhanin.

Me skenarin bazë të Komunikatës së Tretë Kombëtare mbi Ndryshimet Klimatike, shpenzimi i energjisë është projektuar të rritet për 48% si energji përfundimtare deri në vitin 2032, dhe për 102% deri në vitin 2050. Pjesa më e madhe në shpenzimin e energjisë përfundimtare lidhet me

¹⁴ <http://floodlist.com/europe/southern-europe-floods-update-macedonia>.

¹⁵ Komunikata e Tretë Kombëtare mbi Ndryshimet Klimatike, viti 2014, www.unfccc.org.mk.

¹⁶ Ibid.

dizelin, shfrytëzimin e energjisë elektrike dhe gazit natyror. Rritja më e madhe në shpenzimin e energjisë përfundimtare gjatë periudhës 2011-2050 pritet të jetë në sektorin e transportit (rreth 172%) dhe në atë të bujqësisë (164%). Kërkesa e shtuar për energji lidhet me furnizimin e rritur të energjisë, dhe baza e strategjisë së zbutjes është pjesa e rritur e vajit të papërpunuar dhe gazit natyror, pjesa e zvogëluar e thëngjillit (pas vitit 2032) dhe kontributi i shtuar i burimeve të energjisë së ripërtërishe (me përjashtim të biomasës) për 11% gjatë periudhës 2011 – 2050, kryesisht të llogaritur me energjinë hidro dhe të erës. Fatkeqësisht, energjia solare është e kufizuar në skenarët.

Masat të cilat nevojiten për të ndikuar në kërkesën e energjisë përfshijnë shpenzim efikas të energjisë në sektorin e ndërtimitarisë, të transportit dhe promovim të karburanteve me karbon të ulët, fushata për ngritjen e vetëdijes për shprehitë e transportimit, përmirësimin e infrastrukturës së transportit dhe përmirësimin e shpenzimit efikas të energjisë në proceset industriale. Një nga masat më të rëndësishme për reduktimin e emetimeve të gazrave serrë nga sektori i mbeturinave dhe i bujqësisë është ndërtimi i centraleve elektrike me biogaz.¹⁷

3.1 Statusi i të rinjve në Maqedoni

Maqedonia ka popullatë prej mbi 2 milionë njerëz, nga të cilët, 17.7% janë të moshës midis 15 dhe 24 vjeçare. Ka një nga shkallët më të larta të papunësisë në Evropë dhe papunësia tek të rinjtë për momentin ka arritur shkallën e paimagjinueshme prej 50%¹⁸. Pasi shkalla e papunësisë të të rinjtë ka përmasa aq të mëdha në vend, lufta kundër papunësisë të të rinjtë paraqet një nga prioritetet kryesore të shtetit. Duke pasur parasysh se në disa komuna të caktuara shkalla e papunësisë tek të rinjtë arrin madje dhe 80%, të rinjtë mund të shpallen, dhe t'u jepet statusi i një grupi shoqëror vulnerabil.

Pasi që një ligj kontrovers mbi të rinjtë u hodh poshtë në vitin 2011, organizatat e të rinjve vendosën të bashkonin forcat dhe nëpërmjet një procesi të gjerë dhe të hapur të këshillimit, krijuan Këshillin Rinor Kombëtar të Maqedonisë¹⁹. Këshilli paraqet një ombrellë të organizatave rinore, degëve rinore të partive politike në Maqedoni dhe zërin e të rinjve në dialogun me institucionet përkatëse. Kështu, të krijuara në një proces

¹⁷ Komunikata e Tretë Kombëtare mbi Ndryshimet Klimatike, viti 2014, www.unfccc.org.mk.

¹⁸ Republika e Maqedonisë – Zyra Shtetërore Statistikore, Rezultatet mbi popullatën aktive të Republikës së Maqedonisë nga Hulumtimi i Forcës së Punës, tremujorshi IV, viti 2014, <http://www.stat.gov.mk/pdf/2015/2.1.15.04.pdf>.

¹⁹ www.nms.org.mk.

legjitim demokratik, dhe aktualisht duke qenë vend kandidat për t'u bërë anëtar në Forumin Rinor Evropian, institucionet nacionale në Maqedoni ende nuk kanë pranuar zyrtarisht Këshillin si partner për krijimin e politikave relevante mbi të rinjtë. Forma tjera të përfaqësimit të të rinjve në institucionet shtetërore janë këshillat rinor komunal, me direktivë vertikale nga Qeveria, dhe disa janë nisur nga OJQ lokale.

Nuk ekziston një politikë e posaçme mbi të rinjtë që i është caktuar ndonjë ministrie në kuadër të kornizës institucionale dhe ndarjes së ministrive në Maqedoni, por ekziston vetëm një agjenci e përbashkët e cila merret me politikat e të rinjve dhe sportit. Kombinimi i këtyre dy politikave brenda një agjencie të vetme në disa raste rezulton me vëmendje të pamjaftueshme në çështjet e të rinjve, por me presionin e shoqërisë civile dhe Këshillit Rinor Kombëtar, vëmendja për çështjet e të rinjve përmirësohet. Procesi i krijimit të Strategjisë së të Rinjve 2016-2025 ka filluar me një proces inkluziv, të drejtuar nga Agjencia për të Rinj dhe Sport dhe Misioni i UNDP-së në Maqedoni, dhe shfaq shenja pozitive të procesit të këshillimit inkluziv. Qëllimi i Strategjisë është të ofrojë kornizë për trajtimin e çështjeve të të rinjve lidhur me arsimin, punësimin dhe gjendjen ekonomike dhe të shpresojmë se kjo do ta përmirësojë statusin e të rinjve në Maqedoni.

Një nga institucionet më të rëndësishme qeveritare, e cila është e detyruar t'i trajtojë të rinjtë dhe ta përmirësojë procesin për të rinjtë që kërkojnë punë, është Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë. Hulumtimi i "Reactor – Research in Action" jep një analizë të efektshmërisë së Agjencisë për Punësim në lëmin e papunësisë tek të rinjtë, si dhe nivelin e vetëdijes tek të rinjtë për shërbimet që kjo Agjenci u ofron atyre, për të ulur shkallën e papunësisë të të rinjtë. Rezultatet e fituara nga hulumtimi mund të shërbejnë edhe si një tregues për të rinjtë të papunë, të cilët kanë qasje në masat aktive për punësim. Për shembull, vetëm 11.4% të të rinjve kanë deklaruar se kanë marrë këshillë se si të kërkojnë punë; vetëm 5.3% kanë marrë informacione për vende të lira pune; 2.6% kanë përfituar nga udhëzimet mbi mundësitë e arsimimit dhe trajnimit; 2.6% janë përfshirë në programe të arsimit/trajnimit; dhe 82.5% kanë deklaruar se asnjëherë nuk kanë pranuar ndonjë udhëzim ose ndihmë nga Agjencia.²⁰ Një konkluzion tjetër i rëndësishëm që mund të nxirret nga ky hulumtim është se të rinjtë në Maqedoni shohin rëndësinë e kombinimit të arsimimit formal dhe punës praktike si një formë më praktike të ndihmës në kërkimin e vendeve të përshtatshme të punës.

²⁰ Reactor – Research in Action. "Rinia dhe tregu i punës", viti 2012, fq. 45.

Tabela 1. Cili lloj i edukimit mendoni se do të ishte më i dobishëm për të gjetur punë?

	Frekuenca	%
Kryerja e trajnimit profesional	14	12.3
Kryerja e shkollës së mesme	2	1.8
Kryerja e arsimit të lartë	41	36.0
Puna praktike tek një punëdhënës	22	19.3
Trajnimi mbi sipërmarrësin për të filluar biznesin vetanak	1	.9
Kursi i kompjutorit dhe TI	10	8.8
Gjuhët e huaja	13	11.4
Trajnimi profesional	8	7.0
Tjetër	3	2.6
Gjithsej	114	100.0

Reactor – Research in Action. “Të rinjtë dhe tregu i punës”, viti 2012

4. KLIMA DHE ENERGJIA – RASTI I SERBISË

Serbia ka qenë një dëshmitar fatkeq i pasojave të ndryshimeve klimatike, duke iu nënshtruar kushteve ekstreme të motit, që rezultoi me përmytje. Shpenzimet e drejtpërdrejta nga përmytjet në vitin 2014 u vlerësuan diku 600 milionë euro²¹. Sipas Komunikatës së Parë Kombëtare mbi Ndryshimet Klimatike, pasojat e ndryshimeve klimatike në Serbi më së shumti do të prekin burimet ujore, bujqësinë dhe pylltarinë. Fatkeqësitë natyrore kryesisht kanë të bëjnë me përmytjet, ndërsa zjarret pyjore janë bërë një kërcënim serioz gjatë viteve të fundit. Mungesa e ujit do të dëmtojë prodhimet bujqësore dhe prodhimin në hidrocentralet, por edhe shfrytëzimi i ujit për proceset e ftohjes dhe proceset tjera teknologjike që bëjnë pjesë të termocentraleve me thëngjill.

Sektori energjetik është kontribuuesi më i madh i emetimeve të gazrave serrë, me 77.7%, sektori bujqësor merr pjesë me 14.64%, dhe transporti me 11% nga emetimet e përgjithshme. Analiza ka treguar se, për të reduktuar emetimet e gazrave serrë nga sektori energjetik, nevojitet rritje e efikasitetit të energjisë dhe burimeve të energjisë së ripërtërishme²². Sektori energjetik në Serbi varet në masë të madhe nga karburantet fosile, që përfaqëson më se 50% të miksit energjetik të Serbisë, nga të cilët, më se 40% importohen. Sipas balancit energjetik në vitin 2009, shpenzimi i energjisë përfundimtare përbëhet nga 32% të vajit, 9% të linjtit, 9% të

²¹ Serbia dhe ndryshimet klimatike, www.cekor.org, viti 2015

²² Komunikata e Parë mbi Ndryshimet Klimatike brenda UNFCCC, viti 2010.

gazit natyror, 28% të energjisë elektrike dhe 13% të drurit²³. Nga 28% të energjisë elektrike, 65-70% vijnë nga termocentralet me thëngjill dhe rreth 30% nga hidrocentralet, me çka kjo energji do të përbëjë 7.5-8% nga energjia e përgjithshme përfundimtare. Megjithatë, shumë ekspertë në Serbi pretendojnë se druri aktualisht përfaqëson 15-20% të energjisë së përgjithshme përfundimtare.²⁴ Ekspertët shohin potencialin e tranzicionit në sistemet e ngrohjes, me zëvendësimin e drurit me burime të energjisë së ripërtërishme. Megjithatë, teknologjia e centraleve të energjisë me thëngjill të instaluara aktualisht nuk mundëson një kalim të lehtë drejt përdorimit të burimeve të energjisë së ripërtërishme. Burimet e energjisë së ripërtërishme në Serbi janë kryesisht hidroenergja dhe biomasa. Energjia solare fatkeqësisht nuk ka pjesë të konsiderueshme në energjitë e ripërtërishme të Serbisë.

Aq më tepër, pjesë e madhe e shoqërisë në Serbi nuk janë në gjendje t'i paguajë llogaritë e tyre të energjisë. Rreth një milion të qytetarëve janë kualifikuar për pagim me ndihmë sociale të nevojave bazë të energjisë nga 350kW në muaj, dhe më se 60% të amvisërive varen nga karburantet e fortë për ngrohje dhe gatim.²⁵ Reduktimi i varfërisë duhet të vendoset në agjendën e zhvillimit të sektorit energjetik. Decentralizimi i sistemit energjetik duhet të sjellë reduktim të varfërisë, si dhe zhvillim të qëndrueshëm në sektorin energjetik.

Menaxhimi i ujërave është me rëndësi të madhe për sistemin energjetik në sigurimin e sasive të mjaftueshme të energjisë së pastër dhe të qëndrueshme, duke ruajtur ujin të paprekur. Aq më tepër, zhvillimi i burimeve të energjisë së ripërtërishme dhe decentralizimi i sistemit energjetik varet në masë të madhe nga bujqësia dhe pylltaria, gjegjësisht nga biomasa dhe biogazi. Vetëm 2-3 % të buxhetit kombëtar është ndarë për bujqësi gjatë viteve të fundit, që është shumë pak në krahasim me vendet tjera evropiane. Sipas vlerësimeve të caktuara, potenciali i energjisë së biomasës mund të dyfishohet në Serbi, që sot arrin afro 3 400 000 tonë. Natyrisht, këto masa duhet të përshtaten me kujdes me nevojën për bujqësi dhe pylltaris të qëndrueshme dhe të rezistueshme ndaj klimës.²⁶

²³ Balanci i energjisë – energjia përfundimtare, viti 2009, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

²⁴ Zvezdan Kallmar, Koordinator për Energji dhe Ndryshime Klimatike të OJQ-së CEKOR (www.cekor.org).

²⁵ Vlerësimi i lëndueshmërisë klimatike për Serbinë, viti 2012, Forumi i Evropës Juglindore mbi Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike.

²⁶ Ibid.

4.1 Statusi i të rinjve në Serbi

Serbia nuk dallon shumë nga fqinjët e saj të Ballkanit për nga fakti se ka një shkallë të lartë të papunësisë tek të rinjtë. Të rinjtë nga moshë 15 deri 24 vjeçare përfaqësojnë 12% të popullsisë së përgjithshme me aftësi pune të Serbisë. Sipas Zyrës Statistike të Republikës së Serbisë, kjo shkallë arrin 49.4%, gjë kjo që shkakton disa nga problemet socio-ekonomike në këtë vend.

Me një përqindje aq të lartë të të rinjve të papunë, shteti ka prioritetuar hartimin e politikës për të rinjtë në nivelin më të lartë institucional të vendit. Ministria e të Rinjve dhe Sportit është institucioni parësor që harton legjislacionin në lidhje me përfaqësimin e të rinjve në shoqërinë e Serbisë, dhe i është dhënë detyra e zgjidhjes së çështjeve që prekin këtë grup shoqëror vulnerabil. Serbia ka filluar procesin e krijimit të Strategjisë Kombëtare të parë për të Rinjtë në vitin 2007 dhe sot, në vitin 2015, procesi fillon sërish me përfaqësimin e të rinjve nga organizatat e shoqërisë civile, për ta siguruar kontributin e të rinjve në procesin vendimmarrës. Këshilli Rinor Kombëtar i Serbisë - "Krovna Organizacija Mladih Srbije (KOMS)", i cili vepron në partneritet me zyrat rinore lokale në nivelin komunal, sigurohet se të rinjtë janë të pranuar, të përfaqësuar dhe shihen si partnerë të vlefshëm në krijimin e politikave për të rinj. Për arsye të punës dhe përvojës së tyre në përfaqësimin e të rinjve në Serbi, KOMS shihet si një partner i vlefshëm në krijimin e Strategjisë vijuese Kombëtare për të Rinj. Edhe pse ekziston një komunikim përkatës midis institucioneve shtetërore dhe organizatave rinore të shoqërisë civile, nevojitet një qasje më e strukturuar për të luftuar shkallën e papunësisë te të rinjtë.

Siç është prezantuar në tabelën më poshtë, nga muaji prill 2008 deri në prill 2011, shkalla e punësimit të popullatës me aftësi pune ka rënë nga 54% në 45.5%, ndërsa shkalla e papunësisë është rritur nga 14% në 22.9%. Kriza ekonomike ka qenë posaçërisht e ashpër me të rinjtë (të moshës 15-24 vjeçare), pasi efektshmëria e tyre në tregun e punës është keqësuar në mënyrë të përshpejtuar, në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë në moshë pune. Rënia e evidentuar kumulative e punësimit tek të rinjtë nga muaji prill 2008 deri në prill 2011ka qenë dukshëm e madhe – rreth 25%, që është dyfishi i rënies së punësimit te popullata në moshë pune.²⁷

²⁷ "Vlerësimi i programeve aktive të tregut të punës që janë menduar për të rinjtë me pengesa në Serbi". Fondacioni për Avancimin e Ekonomisë, mund të gjendet në: <http://www.fren.org.rs/node/308>.

		Prill 2009	Tetor 2009	Prill 2010	Tetor 2010	Prill 2011	Tetor 2011	Prill 2012	Tetor 2012	Prill 2013	Tetor 2013
Popullata rinore (15-24)	Shkalla e punësimit	16.8	17.0	15.1	15.2	14.1	13.9	14.3	14.7	14.8	14.2
	Shkalla e papunësisë	40.7	42.5	46.4	46.1	49.9	51.9	50.9	51.2	49.7	49.1
	Shkalla e aktivitetit	28.3	29.5	28.2	28.2	28.1	28.8	29.1	30.2	29.5	27.9
Popullata në moshë pune (15-65)	Shkalla e punësimit	50.8	50.0	47.2	47.1	45.5	45.3	44.2	46.4	45.8	49.2
	Shkalla e papunësisë	16.4	17.4	20.1	20	22.9	24.4	26.1	23.1	25.0	21.0
	Shkalla e aktivitetit	60.8	60.5	59.1	58.8	58.9	59.9	59.7	60.4	61.0	62.2

Burimi: Enti Statistikor i Serbisë (ZSRS), Hulumtimet e forcës së punës dhe kalkulimet vetanake

Shkalla e vetë-punësimit në mesin e të rinjve të Serbisë (nën 6%) është konsiderueshëm më e ulët se niveli mesatar i vetë-punësimit tek të rinjtë në vendet tjera (12%). Ka shumë faktorë shoqërorë dhe kulturorë që shkaktojnë këto shkallë të ulëta. Së pari, shumica e të rinjve të Serbisë janë rritur në familje pa asçfarë përvoje sipërmarrëse, pasi shumica e vendeve të punës janë përqendruar brenda ndërmarrjeve shtetërore dhe publike. Veç kësaj, korniza e pafavorshme rregullator, e trashëguar nga dekada e fundit e shekullit njëzet, mungesa e fondeve të disponueshme për të themeluar biznese të reja dhe shërbimet e pazhvilluara të këshillimit afarist gjithashtu kanë penguar sipërmarrësin tek të rinjtë. Sido që të jetë, ky lloj i punësimit mund të dëshmohej si jashtëzakonisht i rëndësishëm për nxitjen e perspektivave për punësimin e të rinjve, sidomos në rrethana ku mundësitë e punës së paguar janë të kufizuara. Aq më tepër, karakteristikat e vetë-punësimit – orari fleksibël i punës, pavarësia më e madhe, kënaqësia nga puna dhe mundësia e të ardhurave më të larta – do t'i kishte kënaqur në masë të madhe aspiratat e të rinjve.²⁸

5. KLIMA DHE ENERGJIA – RASTI I KOSOVËS

Duke qenë një vend i ri, kapaciteti i Kosovës dhe përvoja në trajtimin e ndryshimeve klimatike është shumë e kufizuar, duke pasur prioritete tjera

²⁸ Ristić, Dr. Zoran. Pavlović, Liljana. "Nevojat e tregut të punës dhe pozita e të rinjve të papunësuar", Bashkimi i Punëdhënësve të Serbisë, viti 2012, fq.8.

më urgjente që kanë pasur përparësi gjatë viteve të fundit. Informacionet e disponueshme mbi emetimet e gazrave serrë në Kosovë, dhe projektimet e tyre, janë ende të pamjaftueshme. Një numër i madh politikash dhe dokumentesh strategjike tanimë janë përpiluar dhe miratuar, por ato ende presin zbatimin e tyre. Kosova akoma nuk ka një regjistër të burimeve dhe emetimeve të gazrave serrë, dhe as nuk ka përcaktuar një vit bazë nga i cili emetimet e gazrave serrë do të vlerësoheshin. Vendi ende nuk ka filluar të dërgojë Komunikata Nacionale në Sekretariatit e UNFCCC-së.

Edhe pse Kosova ende nuk ka nënshkruar Konventën Kornizë mbi Ndryshimet Klimatike të KB-ve (UNFCCC), dhe as Protokollin e Kjosos, vendi megjithatë është i detyruar të përmbushë kërkesat e Konventës dhe Protokollit, pasi është një nga vendet nënshkruese të Traktatit të Komunitetit Energjetik, dhe është angazhuar për objektivat e BE-së 20-20-20.

Baza e sistemit energjetik janë centralet elektrike me ndezje të linjitet. Rezervat e linjitet në Kosovë, që arrijnë diku 12.5 bilionë tonë, mendohen të jenë rezervat më të mëdha të linjitet në Evropë. Megjithatë, si një vend që aspiron anëtarësimin në BE dhe palë kontraktuese e Komunitetit Energjetik, Kosova është angazhuar të arrijë objektivin indikativ të kursimit të energjisë me 9% të shpenzimit të energjisë përfundimtare midis viteve 2009 dhe 2018, dhe për të rritur burimet e energjisë së ripërtërishme. Kosova ka për qëllim zhvillimin e energjive të ripërtërishme (energjinë e erës, ujërave dhe atë solare), duke mbuluar 26 % të nevojave të saja për energji deri në vitin 2020 – për momentin, energjitë e ripërtërishme llogaritet të jenë më pak se 3 %. Aq më tepër, biomasa është identifikuar si burim lokal nga i cili komunat mund të kenë leverdi dhe mund t'i përmirësojnë ekonomitë e veta²⁹.

Burimi më i rëndësishëm i emetimeve të gazrave serrë për Kosovën është djegia e karburanteve të fortë – linjiti i vendit. Sektori energjetik prodhon diku rreth 82% nga emetimet e përgjithshme kombëtare të gazrave serrë. Emetimet e gazrave serrë në sektorin e transportit rriten për arsye të rritjes së numrit të makinave, duke rritur kështu dhe shpenzimin e karburantit. Ashtu si rriten të ardhurat e njerëzve edhe sistemet rrugore zhvillohen gjithnjë e më tepër, rëndësia e kësaj kategorie me siguri do të rritet.³⁰

Planet e Kosovës për ta ngadalësuar rritjen e emetimeve të gazrave serrë, do të zbatohen me zhvillimin e burimeve të energjisë së ripërtërishme, shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe efikasitetin

²⁹ "Roli i burimeve të energjisë së ripërtërishme dhe Efikasiteti energjetik në zhvillimin ekonomik të komunave", Hamdi Malushaj, qershor, viti 2014.

³⁰ Strategjia Kornizë mbi Ndryshimet Klimatike, Ministria e Ambientit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Kosovë, viti 2014.

energjetik në të gjithë sektorët³¹. Sipas Studimit të Institutit të Bankës Botërore mbi efikasitetin energjetik gjatë ndërtimit të godinave kombëtare të vitit 2013, sektori i ndërtimitarisë llogaritet të mbajë 48% të shpenzimit të energjisë dhe paraqet pjesën më të madhe të shpenzimit të energjisë përfundimtare të Kosovës. Kontributi më i madh i potencialit për kursim të energjisë vjen nga sektori i banimit (72%), i vijuar nga sektori privat dhe ai tregtar (20%). Potenciali i përgjithshëm i kursimit të energjisë i godinave komunale dhe qendrore është i ulët në krahasim me dy sektorët tjerë (8%). Ky fakt sugjeron se çfarëdo programi për efikasitet të energjisë duhet të fillojë zbatimin e masave në godinat publike. Aq më tepër, pritet që Efikasiteti energjetik të përmirësohet me zbatimin e Planit të Veprimit të Kosovës mbi Efikasitetin Energjetik për vitet 2010-2018, i cili do të caktojë standarde të efikasitetit energjetik, do të promovojë dhe rrisë vetëdijen, do të vendosë një sistemi auditimi të energjisë, dhe do të vendosë skema subvencionimi/huamarrjeje për masat e efikasitetit energjetik.

Kosova përballlet me probleme të konsiderueshme teknike dhe humbje të energjisë elektrike. Infrastruktura energjetike duhet të përmirësohet dhe duhet të ndahet një pjesë adekuate të investimit për këtë fushë.

5.1 Statusi i të rinjve në Kosovë

Kosova njihet si vendi me popullsi më të re në Evropë, me më se 70% të popullsisë së përgjithshme prej 1.8 milionë që janë në moshë nën tridhjetë-e-pesë-vjeçare. Shkalla e papunësisë në Kosovë është shumë e lartë. Sipas sondazhit mbi forcën e punës në Kosovë, të zbatuar në vitin 2012, rinia e Kosovës ka dyfish më tepër gjasa të jetë e papunësuar, në krahasim me grupmoshat tjera të popullatës së kualifikuar brenda forcës së punës. Në mesin e atyre që janë të moshës 15 deri 24-vjeçare, 55.3% janë të papunësuar, ndërsa kjo shkallë është edhe më e theksuar në mesin e vajzave të reja – 63.8%, krahasuar me shkallën e papunësisë nga 52.0% në mesin e djemve të rinj. Kjo statistikë jo vetëm se thekson shkallën alarmuese të papunësisë tek të rinjtë në Kosovë, por gjithashtu edhe çështjen e pabarazisë gjinore në vendin e punës –një sfidë e cila kërkon vëmendjen e zyrtarëve Kosovar.³²

Në përgjithësi, sistemi arsimor në Kosovë për momentin ballafaqohet me shumë sfida. Megjithatë, ka zhvillime pozitive në arsimin dhe punësimin, të cilat të rinjtë e Kosovës mund t'i shqyrtojnë për të përmirësuar gjasat e punësimit të tyre në tregun e punës. Shkalla e papunësisë për ata që

³¹ Ibid.

³² Myha Derenusha, "Papunësia tek të rinjtë në Kosovë", Shoqata për Ndihmë në Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut DEMAS, viti 2013, fq. 1.

posedojnë diplomë të arsimit të lartë është 80%, dhe vepron si një stimulim për Kosovarët e rinj të vazhdojnë arsimin për t'i rritur perspektivat e tyre për karrierë. Shkalla e papunësisë në mesin e të paarsimuarve është më e larta (62.5%), në krahasim me 15.6% të atyre që kanë kryer shkollim të lartë – që kanë numrin më të ulët. Është evidente se arsimi nuk përmirëson perspektivat e punësimit në tregun lokal të punës, dhe si rezultat i kësaj, duhet ofruar arsim të qasshëm dhe me cilësi të lartë.³³

Tabela 3: Numri i të papunëve dhe shkalla e papunësisë sipas nivelit më të lartë të shkollimit dhe gjinisë në Kosovë

Kosovë – Shkalla e papunësisë (%)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Pa arsim	56.0	82.1	62.5
Klasa I-VIII/IX	40.3	59.0	44.6
Shkolla e mesme teknike	25.9	36.1	28.0
Shkolla e mesme / Gjimnazi	35.4	50.2	38.8
Arsimi terciar	11.5	24.4	15.6
Gjithsej	28.1	40.0	30.9

Burimi: Rezultatet e anketës së forcës së punës, Kosovë, viti 2012

Kosova ka "Strategji për të Rinjtë 2013-2017", e cila ka për qëllim përmirësimin e pozitës së të rinjve të moshës midis 15 dhe 24 vjeçare dhe punën e organizatave të shoqërisë civile. Një hulumtim u zhvillua, me qëllim grumbullimi i informacioneve mbi krijimin e Strategjisë mbi të Rinjtë. Janë identifikuar 88 organizata të shoqërisë civile rinore, të cilat konsiderohet se përfaqësojnë zërin e të rinjve në Kosovë. Edhe pse Kosova nuk ka një Këshill Rinor Kombëtar, organizata të tilla ombrellë ekzistojnë në vendet tjera të Ballkanit dhe ka potencial për themelimin e saj në Kosovë. Qëllimi i një projekti të tillë do të ishte të krijohej një zë koherent, i cili do të përfaqësonte dhe inkuadronte 88 organizatat rinore të shoqërisë civile, të cilat janë identifikuar në vend.

Veç kësaj, rezultatet e hulumtimeve të tjera në këtë fushë tregojnë konsolidimin e Këshillit Lokal të Veprimit Rinor (KLVR) dhe kjo konsiderohet të jetë pjesë e shoqërisë civile. Sipas të njëjtit studim, ka 33 KLVR të cilat kanë mbulesë prej 89% në 37 komunat. Komunat që nuk kanë KLVR janë komuna të reja ose më të vogla, me proporcion më të madh të etnisë serbe. Megjithatë, procesi i themelimit të KLVR-ve në këto komuna tanimë ka filluar.³⁴ Ngjashëm me lidhjen midis KLVR-ve dhe komunave të tyre

³³ Ibid.

³⁴ Strategjia e Kosovës mbi të Rinjtë 2013-2017, Ministria e Kulturës, të Rinjve dhe Sportit, Prishtinë, viti 2013, fq. 12.

respektive, Këshilli Qendror i Veprimit Rinor (KQVR) është përgjegjës për përfaqësimin e zërit të të rinjve në komunikimin me institucionet e nivelit qendror (kryesisht Ministria e të Rinjve, Kulturës dhe Sportit).

Është me rëndësi të theksohet se të rinjtë në Kosovë nuk kanë mundësi të studiojnë energjitë e ripërtërishme dhe efikasitetin e energjisë, gjegjësisht, nuk ka universitet i cili ofron këtë lloj të programit studimor, ndërsa kjo është me rëndësi për zhvillimin e ardhmërisë së ekonomisë me karbon të ulët të vendit.

6. KLIMA DHE ENERGJIA – RASTI I KROACISË

Në vitin 2014 Kroacia gjithashtu u godit nga shira të rëndë dhe përmbytje të mëdha, me humbje të paçmueshme njerëzore dhe materiale që ndodhën në vitin 2014³⁵. Ndryshimet e skajshme të klimës kanë efekt të fuqishëm negativ mbi zhvillimin socio-ekonomik të vendit, veçanërisht mbi ekonominë e vendit, i cili është shumë i varur nga bujqësia dhe turizmi.

Si një vend anëtar i BE-së që nga 1 korriku 2013, Kroacia duhet të zhvillojë dhe të zbatojë një strategji vetanake të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike deri në vitin 2017. Si anëtare e BE-së që nga 1 korriku 2013, Kroacia duhej të hartonte dhe të zbatonte strategjinë e vet të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike deri në vitin 2017. Gjatë procesit të anëtarësimit në BE Kroacia ka transponuar dhe ka zbatuar politika të pakos së BE-së mbi klimën dhe energjinë. Kroacia përpilon dhe dërgon raportet e veta vjetore, sipas UNFCCC-së dhe Protokollit të Kjotos. Burimi më i madh i emetimeve të gazrave serre në Kroaci në vitin 2010 ka qenë në sektorin energjetik (73%), vijuar nga bujqësia (11,4%), industria (11,3%) dhe mbeturinat (3,8%)³⁶.

Shumica e kërkesave për energji të Kroacisë ende plotësohen me thëngjill, ndërsa shumica e vajit të vendit importohet nga jashtë. Strategjia energjetike (e vitit 2009) ka për qëllim të ndërtojë dy centrale elektrike me ndezje të thëngjillit dhe përmend mundësinë e nisjes së programit kroat të energjisë bërthamore dhe terreneve për hedhje të mbeturinave radioaktive. Aq më tepër, Qeveria Kroate u ka dhënë kompanive të vajrave licenca për eksplorimin dhe eksplotimin e hidrokarbonëve në Detin Adriatik. Krahas objektivave të angazhimit të BE-së dhe potencialit të ripërtërishëm të energjive solare, të erës dhe biomasës, vendimet e fundit të Qeverisë Kroate vënë në pyetje angazhimin e vendit për zhvillim të ekonomisë me karbon të reduktuar.

³⁵<http://www.reuters.com/article/2014/09/14/us-croatia-flood-idUSKBN0H90IN20140914>.

³⁶ Komunikata e Pestë Kombëtare e Republikës së Kroacisë në kuadër të UNFCCC-së.

Kroacia ka potencial të lartë të energjisë së erës dhe atë solare, përderisa hidroenergji shënon stagnim gjatë njëzet viteve të fundit, energjia solare thuhet tërësisht është braktisur. Objektivat strategjik të Strategjisë Energjetike (të vitit 2009) përfaqësojnë 20% të burimeve të energjisë së ripërtërishme në shpenzimin e energjisë përfundimtare deri në vitin 2020, kurse 35% të energjisë elektrike vijnë nga burimet e energjisë së ripërtërishme, përfshirë këtu dhe hidrocentralet deri në vitin 2020 në gjenerimin e përgjithshëm të energjisë elektrike. Megjithatë rritja e energjisë së "pastër" është shumë pozitive nga pikëpamja ekologjike, pasiguria e ndryshimeve klimatike detyron diversifikim të mëtueshëm, në burimet siç janë energjitë gjeotermale ose biomasa. Hidroenergji, energjia solare dhe centralet elektrike me erë me siguri më së shumti do të dëmtohen nga ndryshimet klimatike. Në veçanti shqetëson rënia e potencialit hidroenergjetik, si rezultat i reshjeve të pakësuar dhe zvogëlimit të ujërave sipërfaqësore gjatë shekullit të ardhshëm: një rënie prej 50% në prodhimin e hidroenergjisë ka gjasa të ndodh deri në fund të shekullit 21.³⁷

Sipas studimit të UNDP-së, me masat e efikasitetit energjetik do të arrihet që në 20% të vendbanimeve të hapen 7.000 vende të drejtpërdrejta pune gjatë dekadës së ardhshme. Arritja e objektivave të Strategjisë Energjetike për vitin 2030 në fushën e bashkë gjenerimit të biomasës (ngrohja dhe energjia elektrike), dhe tregu i brendshëm i biomasës së prodhuar lokalisht (pelete, brikete, ashklla) do të hap 5.000 vende të drejtpërdrejta pune dhe 55.000 vende të tërthorta, të nxitura, ndërsa arritja e objektivave të Strategjisë Energjetike për vitin 2030 për sisteme termale solare do të hapin 1,300 vende të drejtpërdrejta të punës, dhe 2.000 të tërthorta, të krijuara, konkludon studimi i UNDP-së.

6.1. Statusi i të rinjve në Kroaci

Edhe Kroacia ka problemet e veta me papunësinë tek të rinjtë, dhe aderimi i saj në BE pati efekt të pakët mbi zbritjen e shkallës së papunësisë tek të rinjtë në afat të mesëm. Me njerëzit e rinj të moshës 15-24 vjeçare që përfaqësojnë 11.7% të popullatës, dhe shkallë tronditëse të papunësisë tek të rinjtë nga 44,8% (Eurostats, janar, viti 2015), Kroacia përballlet me një luftë për të siguruar punësim cilësor, arsim dhe përfshirje të këtij grupi shoqëror.

Logjikisht këto lëvizje shqetësuese kanë ngritur vetëdijen në mendjen e publikut lidhur me pozicionimin e të rinjve në tregun e punës. Me sa duket, një numër i madh vendimarrësish dhe ekspertësh kanë filluar ta kuptojnë efektet potencialisht të dëmshme, nëse këto trende vazhdojnë kështu.

³⁷ UNDP, 2008.

Garancia për të Rinjtë e BE-së përballet me sfida strukturore, kurse palët e interesuara, të cilat janë më së shumti të dëmtuara me këtë çështje, pra vetë të rinjtë, janë kryesisht të përjashtuar nga debati.³⁸ Kur vlerësohet procesi i bashkëpunimit midis organizatave rinore dhe vendimmarrësit brenda institucioneve, bëhet e dukshme se të dy palët iniciojnë komunikim lidhur me temën, brenda interesave të tyre vetanake. Megjithatë, lidhur me pranimin e ideve dhe iniciativave, anëtarët e organizatave rinore më tepër përballet me reagimin negativ nga institucionet shtetërore sesa e kundërta. Megjithatë, duhet theksuar se organizata ombrellë e organizatave rinore në Kroaci, pra Rrjeti Rinor i Kroacisë (Mreža Mladih Hrvatske – MMH) bën përpjekje të konsiderueshme për të krijuar një zë të unifikuar të të rinjve, i cili kërkon përfshirjen e të rinjve në procesin e vendimmarrjes.

Njëjtë si vendet e rajonit, edhe Kroacia përballet me problemin e joeffikasitetit institucional dhe sfidën e zbatimit të ligjeve dhe strategjive. Cilësia e punës të cilën Shërbimi i Punësimit të Kroacisë (SHPK) e kryen në vend nuk kënaq standardin e nevojshëm, nëse e kemi parasysh reagimin e të rinjve. Të rinjtë shohin veten si “klientë” të kornizës së SHPK-së dhe ata shohin këtë institucion si pikën primare të shërbimit, e cila supozohet të ofrojë ndihmë dhe informacione cilësore lidhur me vendet potenciale të punës, dhe u ndihmon atyre në gjetjen e punës në ndërmarrjet private.

Si vendi më i ri i BE-së, Kroacia mbajti Panairin e vet të parë të punësimeve në BE³⁹ më 4 tetor të vitit 2013, ku ishin të pranishëm 88 punëdhënës dhe pati më se pesë mijë vizitorë për të parë mundësitë e zhvillimit. Megjithatë, nuk ka të dhëna për atë se sa njerëz, në fakt, janë punësuar si rezultat i panairit.

Ndërtimi i një sistemi të volitshëm të punësimit për të rinjtë kërkon koordinimin e grupeve shoqërore, institucioneve dhe ndërmarrjeve private. Përderisa legjislacioni i tanishëm në Kroaci orvatet të mbrojë punonjësit, duke vendosur rregulla të rrepta që e bëjnë të vështirë ndërprerjen e punësimit të punonjësve, të rinjtë e Kroacisë vështirë e shohin veten madje edhe si pjesë potenciale të forcës së punës. Rritet numri i punëdhënësve që nuk janë të gatshëm të punësojnë punonjës të rinj, për shkak të frikës se, gjatë kohës së krizës, ata nuk do të mund t’i përjashtojnë nga puna për ta shpëtuar kompaninë. Në këtë lloj ambienti, njerëzit e rinj

³⁸ Buković Nikolla, “Kush frikohet nga kriza e madhe dhe e keqe? - Dialogu i strukturuar mbi papunësinë tek të rinjtë”, Rrjeti i të Rinjve të Kroacisë (MMH). Mund të gjendet në:

<http://www.mmh.hr/files/ckfinder/files/Whos%20afraid%20of%20the%20big%20bad%20crisis.pdf>.

³⁹<https://ec.europa.eu/eures/main.jsp?lang=en&catId=10631&myCatId=10631&parentId=20&acro=news&function=newsOnPortal>.

janë zakonisht grupi më vulnerabil, sepse ata më së shumti goditen nga paragjykimet korporative. Edhe në rastet kur posti në kompani nuk kërkon nivel universitar, kompanitë e shtojnë këtë si kusht, për të parashtruar kërkesa joreale gjatë punësimit. Gjithashtu, problemi me punësimin e të rinjve qëndron në faktin se kompanitë zakonisht nuk posedojnë dituri se si t'ia transferojnë gjithë aftësitë e kërkuara një personi të ri, i cili ka mungesë të konsiderueshme të përvojës së punës. Punëdhënësit shpesh dëshirojnë të punësojnë persona me përvojë paraprake sesa persona që do të kenë nevojë për trajnim plotësues.

7. KONKLuzionET / MBI KLIMËN DHE ENERGIJË

Kjo është një pasqyrë e përgjithshme e modeleve në të katër vendet që janë objekt i kësaj analize. Këto konkluzione fokusohen në gjendjen aktuale në vendet dhe në mundësitë që dalin nga skenarët e zbutjes dhe përshtatjes, si dhe në zhvillimin e tanishëm dhe të ardhshëm të zhvillimit të energjisë.

- ✓ Vendet janë vulnerable ndaj fatkeqësive natyrore, sidomos ndaj përmytjeve dhe zjarreve pyjore, andaj do të nevojiten njohuri dhe ekspertiza lidhur me **menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë**, si dhe do të hapen mundësi punësimi për të krijuar programe **sigurimi dhe masa të mbrojtjes sociale**;
- ✓ Sektori i ujërave do të jetë më i ndjeshmi në vendet në fjalë. Mungesa e ujit do të ndikojë mbi bujqësinë dhe sektorin energjetik, gjegjësisht, prodhimin nga hidrocentralet, mirëpo edhe shfrytëzimin e ujit në proceset teknologjike në termocentralet me thëngjill. Do të nevojitet ekspertiza dhe njohuritë në **fuqizimin dhe modifikimin e infrastrukturës fizike, ndërtimin e pendave dhe rezervuarëve, masat e kursimit të ujit, pajisjet për grumbullimin e ujit të shiut, ripërdorimin dhe riciklimin e ujit, etj.**;
- ✓ **Prodhimet në sektorin bujqësor do të pakësohen** dhe do të dëmtojnë ekonomitë e vendeve. Sektori bujqësor konsiderueshëm kontribuon në punësimin e popullatës lokale dhe në këtë mënyrë, shumë njerëz mund t'i humbin të ardhurat e tyre. Nga ana tjetër, masat e zbutjes dhe përshtatjes do të kërkojnë dituri dhe ekspertizë, dhe si pasojë, do të hapen vende pune për **fermerë organik, drejtues të mikro sistemeve të ujitjes (ujitja pikë-pas-pike, spërkatës mikro dhe spërkatje), plehra organik, drejtues të prodhimit të biogazit, dhe përzierje të plehrave**;
- ✓ Kërkesa e energjisë do të rritet në të gjitha vendet, kryesisht nga sektori i transportit dhe i bujqësisë. Planifikohet që kërkesa për

energji të plotësohet me importin e vajit të papërpunuar dhe gazit natyror, dhe me rritje të burimeve të energjisë së ripërtërishe. Për ta pakësuar shfrytëzimin e energjisë, fushatat për ngritjen e vetëdijes dhe edukimi i qytetarëve janë masa vendimtare. Do të hapen vende pune në fushën e **promovimit, organizimit të fushatave, edukimit mbi ambientin jetësor dhe marketingun e qëndrueshëm;**

- ✓ Infrastruktura e energjisë është e vjetërsuar dhe nevojiten investime të konsiderueshme për ripërtëritje dhe avancim të sistemit. Zhvillimi i infrastrukturës kërkon njohuri në **inxhinieri, mirëmbajtje, instalim, sisteme kompjuterike dhe gjeologji;**
- ✓ Thëngjilli është dominues në miksin energjetik. Obligimet ndaj Komunitetit Energjetik krijojnë domosdoshmërinë e ndërprerjes së emetimeve dhe zëvendësimin e centraleve të vjetra elektrike me thëngjill me të reja, preferohen ato që punojnë me gaz ose me energji të ripërtërishe. Ky proces përshtatjeje do të krijojë mundësi punësimi në **zhvillim, ndërtimtari, punime operative, konsulencë, hulumtime dhe zhvillim, inxhinieri, dhe zhvillim të software-it;**
- ✓ Rëndësia strategjike e gazit është në rritje për disa vende, siç janë Maqedonia dhe Kroacia, dhe **do të hapen vende pune në procesin e gazifikimit, ndërtimit dhe instalimit, punës dhe mirëmbajtjes;**
- ✓ Hidroenergjinë paraqet një burim të rëndësishëm energjie dhe do të mbetet i tillë. Sektori hidroenergjetik kërkon mirëmbajtje dhe staf me shkathtësi **inxhinierie, sipërmarrësie, inovacioni, marketingu, teknologji të informacioneve dhe komunikimeve (TIK);**
- ✓ Efikasiteti energjetik paraqet prioritet për shumicën e vendeve dhe ky sektor do të krijojë një numër të konsiderueshëm të vendeve të punës. **Efikasiteti energjetik në proceset industriale, dhe në sektorët e ndërtimtarisë dhe transportit** janë prioritet i cili do të krijojë mundësi punësimi në **ndërtimin e izolimit**, për shembull. Përveç aftësive teknike që kërkohen, nevojiten edhe aftësi lidhur me **inovacionin, aftësi ndërdisiplinore, zgjidhje të problemeve, projektim dhe sisteme;**
- ✓ Transporti do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në zbutjen e emetimeve dhe do të kërkojë ndërhyrje të konsiderueshme të politikave dhe investime në infrastrukturë në fushat siç janë transporti publik, dhe do të ndërmerren masat për të inkurajuar ecjen në këmbë dhe çiklizmin. Do të nevojitet **zhvillimi dhe zbatimi i politikave rregullatorë**, si dhe, përshtatje e **infrastrukturës për linjë alternative transporti dhe organizim të fushatave për ngritjen e vetëdijes;**

- ✓ Biomasa dhe biogazi janë një burim i energjisë që përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme në miksin energjetik të vendeve dhe mbështesin ekonominë në nivelin lokal. Do të nevojiten dituri dhe ekspertizë në këtë sektor për **prodhimin dhe punimin e centraleve elektrike, gjegjësisht, drejtues të prodhimit të biomasës**. Ndërkaq, do të mund të krijohen mundësi punësimi në **grumbullimin e mbeturinave, si dhe klasifikimin dhe riciklimin e tyre**;
- ✓ Era, si një burim energjie, vihet në skenarët e zbutjes së emetimeve të gazrave serrë dhe ky sektor mund të krijojë mundësi punësimi. Dituria, ekspertiza dhe profilet e vendeve të punës në këtë sektor do të lidhen me **inxhinierë për skicim të energjisë së erës, specialistë për vlerësimin e resurseve të erës, teknikë të shërbimit të erës dhe specialistë për instalimin e turbinave të vogla të erës**.

7.1 Konkluzionet lidhur me të rinjtë në Ballkanin Perëndimor

- ✓ Me rreth 50% të papunë, të rinjtë mund të konsiderohen si **grup social vulnerabil në Ballkanin Perëndimor**;
- ✓ Ka **mungesë të dialogut të strukturuar** midis institucioneve dhe të rinjve dhe ata janë pjesërisht të përfshirë në debate mbi politikat që i prekin;
- ✓ Të rinjtë janë të përfaqësuar në institucionet nëpërmjet të organizatave ombrellë, Këshillave Rinorë Kombëtarë, dhe Këshillave Rinorë Lokal. Sido që të jetë, **procesi i planifikimit të buxhetit**, si në nivelin lokal, ashtu edhe në atë nacional **nuk merr në konsideratë nevojat financiare për zhvillimin e sektorit të të rinjve**;
- ✓ Ka **mungesë të mekanizmave për mbështetje të inovacionit dhe sipërmarrësisë** në mesin e të rinjve, dhe si pasojë, shkalla e vetë-punësimit mbetet të jetë e ulët;
- ✓ Mungon bashkëpunimi i strukturuar midis universiteteve dhe kompanive, andaj **të rinjve u mungojnë shkathtësi dhe përvojë praktike pasi që kryejnë studimet**;
- ✓ **Agjencitë e punësimin janë joefektive për të rinjtë** dhe nuk ofrojnë mbështetjen e duhur kur bëhet fjalë për planin e punësimin, trajnimit, zhvillimit të aftësive dhe kompetencave të tregut të punës, sidomos në zonat rurale;
- ✓ Edhe pse universitetet në Ballkan ofrojnë studime që japin aftësi teknike për studentet, **ka mungesë të fleksibilitetit kur bëhet fjalë për azhurnimin ose ndryshimin e programeve studimore** për të përmbushur nevojat e tregut të punës.

Sondazhi online⁴⁰, "Të interesuar për ndryshimet klimatike", u zbatua nga 15 shkurti deri më 15 mars 2015. Qëllimi ishte të vlerësohet vetëdija e të rinjve (të moshës 16-24 vjeçare) mbi ndryshimet klimatike dhe energjisë, si dhe interesat e tyre për të studiuar apo punuar në sektorin e energjisë së pastër (BER/EE). U promovua nëpërmjet të medieëve sociale, organizatave partnere të të rinjve dhe Këshillave Rinorë Kombëtarë nëpër vendet e përfshira. Gjithsej 485 të rinj iu përgjigjen sondazhit. Edhe pse ky numër nuk është statistikisht relevant, mund të na jep ca tregues dhe bazë për të menduar. Përgjigjet e sondazhit na japin këto konkluzione:

- ✓ Të rinjtë **mendojnë se e dinë ç'do të thotë ndryshimi klimatik, por pjesa më e madhe nga ata në fakt nuk e dinë** (pyetjet 1 dhe 2);
- ✓ Ata kanë një ide të përgjithshëm mbi shkakun e ndryshimeve klimatike dhe zgjidhjes së mundshme (pyetjet 3 dhe 4);
- ✓ **Ata janë të interesuar të studiojnë dhe të punojnë në fushën e energjive të ripërtërishme dhe të efikasitetit energjetik**, por ekziston mungesa e vetëdijes dhe informacioneve mbi universitetet dhe kompanitë që ofrojnë këto mundësi (pyetjet 5, 6, 7 dhe 8);
- ✓ **Ata kanë interesim për të studiuar energjinë e ripërtërishme dhe efikasitetin e energjisë nga shumë aspekte të ndryshme**, siç janë inxhinieria, aspekti social dhe shkencor i arkitekturës, drejtësia dhe ekonomia (pyetja 9);
- ✓ **Ka potencial sipërmarrës në energjitë e ripërtërishme dhe në efikasitetin e energjisë dhe tek të rinjtë** pasi ata parafytyrojnë veten duke punuar në sektorin e energjisë së pastër, edhe pse disa nga ata mendojnë se nuk ka mundësi punësimi (pyetjet 8 dhe 10);
- ✓ Nga hulumtimi i universiteteve⁴¹, mund të vijmë në përfundim se **Serbia ka numrin më të madh të universiteteve ku të rinjtë mund të studiojnë burimet e energjisë së ripërtërishme dhe efikasitetin e energjenergjetik**, e vijuar nga Kroacia dhe Maqedonia. **Të rinjtë në Kosovë nuk kanë mundësinë e studimit të burimeve të energjisë së ripërtërishme**, e as efikasitetin e energjisë.

8. REKOMANDIME

- ✓ Reduktimi i varësisë nga karburantet fosil, fokusimi në **decentralizimin e sistemit energjetik**, me vendosjen e mekanizmave për prodhim

⁴⁰ Shtojca I.

⁴¹ Shtojca II.

lokal të energjisë së ripërtërishme, gjë kjo e cila do ta **pakësojë varfërinë dhe do të inkuadrojë qytetarët në këtë proces në mënyrë aktive;**


- ✓ **Rritja e bashkëpunimi rajonal dhe ndërkufitar** dhe përfshirja e ndarjes së diturive midis qeverive, shoqërisë civile, instituteve kombëtare hidrometeorologjike, sektorit privat dhe universiteteve, dhe transferimi i diturisë nga vendet e BE-së;
- ✓ **Bashkëpunimi rajonal do të mundësojë uljen e shpenzimeve për vendet** për mirëmbajtje të furnizimit të brendshëm të energjisë dhe për ripërtëritjen dhe zhvillimin e infrastrukturës energjetike;
- ✓ **Energjia solare ka potencial shumë të madh** i cili është i pashfrytëzuar dhe duhet të vështrohet si prioritet në grupin e burimeve të energjisë së ripërtërishme. Qeveritë duhet të vendosin mekanizma për mbështetjen e industrisë solare dhe për zhvillimin e një programi i cili do të krijojë vende pune;
- ✓ Të zbatohen masa **të kontrollit të prerjes së drunjve dhe të menaxhimit të përshtatshëm të pyjeve**, duke shfrytëzuar potencialin e biomasës;
- ✓ Autoritetet lokale dhe ato kombëtare, hulumtuesit dhe bizneset lokal duhet të krijojnë programe për **vendet e reja të punës për punonjësit nga industrinë në rënie dhe duhet të ofrojnë trajnime;**
- ✓ Çdo subjekt duhet të sigurojë **kriteret e barazisë gjinore, si dhe përfshirjen e grave** gjatë zhvillimit të programeve, politikave dhe masave;
- ✓ Të zhvillohen dituri dhe ekspertizë mbi **inxhinierinë dhe menaxhimin e ujërave**, dhe për këtë duhet të vendoset bashkëpunim me universitetet evropiane; të merret si shembull bashkëpunimi me universitetet holandeze, siç është Universiteti Twente ;
- ✓ Të punohet në drejtim të **tolerancës, respektit, diversitetit kulturor dhe mirëkuptimit** në mesin e qytetarëve, sidomos në mesin e të rinjve.
- ✓ Universitetet duhet të **përmirësojnë promovimin dhe strategjinë e tyre të komunikimit** që kanë të rinjtë në shënjestër.
- ✓ Duhet vendosur **bashkëpunim rajonal midis universiteteve** për të rritur mobilitetin e të rinjve, shkëmbimin e përvojës së nxënies dhe diturive, si dhe programet e targetuara të trajnimit dhe arsimit;
- ✓ Duhet zhvilluar **bashkëpunimin midis universiteteve dhe kompanive për të krijuar qendra inovacioni dhe sipërmarrësie** për të rinjtë;

- ✓ **Aftësitë ndërdisiplinore, aftësitë strategjike dhe të udhëheqjes, aftësitë sipërmarrëse, vetëdija ekologjike, të menduarit sistemik dhe aftësitë e analizës së rrezikut** duhet të jenë në fokus të agjencive të punësimit, qendrave të trajnimit dhe OJQ-ve;
- ✓ Agjencitë e punësimit duhet të krijojnë **skema të mobilitetit të vendeve të punës** për të ndihmuar të rinjtë në gjetjen e vendeve të punës, trajnim dhe punë praktike në vende tjera të BE-së, sipas shembullit të "Your First EURES job" ("Puna yte e parë në BE-BER") me një **sistem i cili siguron mbështetje dhe vazhdimësi të procesit**;
- ✓ Agjencitë e punësimit duhet të zhvillojnë mekanizëm për t'iu **qasur të rinjve në zonat rurale** të cilët janë të përjashtuar në masë të madhe nga shërbimet;
- ✓ Krijimi i një **programi i cili do të inkorporojë aktivizëm rinor, trajnim dhe vullnetarizëm** për t'i motivuar të rinjtë, për t'i bërë të vetëdijshëm për kompetencat e tyre si dhe për t'i mësuar ata si të kërkojnë punë;
- ✓ Universitetet duhet **të rivlerësojnë programet e tyre** dhe duhet t'u ofrojnë studentëve të vet mundësi për të grumbulluar dituri dhe përvoja praktike në kompanitë dhe organizatat e tjera;
- ✓ **Shfrytëzimi i instrumenteve financiare të BE-së**, gjegjësisht, fondin strukturor dhe të investimeve (për Kroacinë) dhe fondet për vendet e treta 2014-2020 (për Maqedoninë, Serbinë dhe Kosovën) për të investuar në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe në mbrojtjen e ambientit jetësor.

SHTOJCA I


SONDAZHI ONLINE PËR TË RINJTË 16 – 24 VJEÇARË

Gjithsej 485 të rinj i përgjigjen sondazhit, nga të cilët, **218 nga Maqedonia, 134 nga Serbia, 73 nga Kosova dhe 60 nga Kroacia.**




Grupmosha: 16-24 vjeç

Grupi i targetuar i sondazhit ishin nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët e universiteteve. 62% nga personat që iu përgjigjen sondazhit janë të grupmoshës 21 deri 24 vjeçare, të cilët tregojnë se studentët janë më të interesuar për ndryshimet klimatike, sesa nxënësit e shkollave të mesme.




Gjinia: 60% femra, 40% meshkuj




1. A e dini se ç'do të thotë ndryshimi klimatik?

92% janë përgjigjur se e dinë çka do të thotë ndryshimi klimatik, gjë që tregon bindjen e të rinjve se janë të vetëdijshëm për këtë çështje. Pyetjet vijuese tregojnë diç më tepër.




2. A është kjo deklaratë e vërtetë? “Ndryshimet klimatike shkaktojnë ngrohjen globale”

60% janë përgjigjur me “po” që nuk është korrekte, kurse 16% “nuk janë të sigurt”, gjë kjo e cila bën 76% të tyre të pavetëdijshëm se çfarë në të vërtetë do të thotë ndryshimi klimatik. Kjo tregon një hendek të madh lidhur me atë se çka mendojnë ata se dinë dhe çka ata në të vërtetë dinë për ndryshimet klimatike.




3. Çka mendoni se është shkaku më i madh i ndryshimeve klimatike?

50% nga të rinjtë e anketuar janë përgjigjur saktë “karburantet fosil”, 20% janë përgjigjur me “fabrikat” kurse 10% mendojnë se “transporti” është shkaku më i madh për ndryshimet klimatike. Të gjitha përgjigjet janë të sakta, por vetëm gjysma nga ata kanë dhënë përgjigjen më të saktë.




4. Cila zgjidhje mendoni se është më e mira për ndryshimet klimatike?

Pothuajse 67% janë përgjigjur me “burimet e energjisë së ripërtërishme”, ndërsa 13% janë përgjigjur me “shpenzimi efikas i energjisë”, që ishin përgjigjet e sakta. Interesante është se, përqindja e të rinjve që janë përgjigjur me “**riciklimi**” (9%) kanë qenë shumë afër me përqindjen e atyre që janë përgjigjur me “Efikasiteti energjetik”.




5. A njihni ndonjë universitet i cili ofron studime në fushën e energjisë së ripërtërishme dhe/ose të efikasitetit të energjisë?

“Jo” dhe “nuk jam i/e sigurt” përbëjnë 67%, gjë kjo e cila tregon përqindjen e madhe të të rinjve që kanë mungesë të informacioneve mbi universitetet që ofrojnë studime lidhur me BER / EE, dhe studime të ngjashme.




6. A dini për ndonjë kompani e cila punon në fushën e energjisë së ripërtërishme dhe/ose efikasitetit të energjisë?

Është interesante se, shumica e të rinjve dinë për ndonjë kompani e cila punon me BER ose EE (40%), në krahasim me universitetet (33%). Përsëri, një përqindje e lartë e të rinjve nuk kanë dijeni (60%) për ndonjë kompani e cila punon në fushën e BER ose EE.




7. A jeni të interesuar për të studiuar energjinë e ripërtërishme dhe/ose efikasitetin energjetik?

Kur kombinon "po" dhe "po", por më nevojiten më shumë informacione", duket se 70% janë të interesuar për të studiuar energjinë e ripërtërishme dhe/ose efikasiteti e energjisë, dhe më se gjysma e tyre kanë nevojë për më shumë informacione. Kjo tregon për potencialin e madh për universitetet dhe shoqërinë që të krijojnë një rezervë të talenteve të energjisë së pastër.




8. A jeni të interesuar të punoni në fushën e energjisë së ripërtërishme dhe/ose të efikasitetit të energjisë?

Një përqindje e lartë prej 73% janë të interesuar të punojnë në fushën e energjisë së ripërtërishme dhe/ose të efikasitetit të energjisë, por gjysma e tyre kanë nevojë për më tepër informacione.




9. Për cilën fushë nga energjia e ripërtërishme dhe/ose efikasiteti energjetik jeni të interesuar?

Ka një shumëllojshmëri të interesave për të studiuar BER/EE. Nuk ka një fushë e cila është evidente dhe e cila mund të definohet si "më e dëshiruar". Megjithatë, *inxhinieria* me 21% është zgjedhja më e preferuar, vijuar nga *aspekti social* (19%), *shkenca* (15%), *ekonomia* (12%) dhe *drejtësia* (10%). Në zgjedhjen "tjetër" të përgjigjes, janë përmendur *politika publike, teknologjia e gjelbër, përmenden siguria dhe TI*.



10. A mendoni se ekzistojnë mundësi punësimi në fushën e energjisë së ripërtërishme dhe/ose të efikasitetit energjetik?

Më se gjysma (56%) e të rinjve mendojnë se ekzistojnë mundësi punësimi në fushën BER/EE. Duke pasur parasysh se 73% dëshirojnë të punojnë në këtë fushë (pyetja 8), ka potencial *sipërmarrësie* për vetë-punësim dhe krijim të vendeve të punës.



SHTOJCA II

LISTA E UNIVERSITETEVE QË OFROJNË STUDIME LIDHUR ME BURIMET E ENERGJISË SË RIPËRTËRISHME DHE/OSE EFIKASITETIN E ENERGJISË⁴²

REPUBLIKA E SERBISË

UNIVERSITETI I BEOGRADIT

Fakulteti i Ekonomisë

Cikli i studimeve: Master

Programi studimor: Ekonomi dhe menaxhimi i energjisë

<http://www.ekof.bg.ac.rs/>

Studenti grumbullon dituri në fushën e ekonomisë, energjisë, organizimit të lëndëve në fushën e energjisë, përcaktimi i çmimeve dhe taksave doganore në sektorin energjetik, sistemeve energjetike, menaxhimit të investimeve dhe të politikës në menaxhimin e energjisë, menaxhimit të resurseve njerëzore, menaxhimit të cilësisë, menaxhimit të punës, si dhe të kapaciteteve makroekonomike për formulimin dhe zbatimin e politikave energjetike.

Fakulteti i Arkitekturës

Cikli i studimeve: Studime të specializuara akademike

Programi studimor: Arkitekturë me efikasitet të energjisë dhe të gjelbër

<http://www.arh.bg.ac.rs/>

Është ky cikli i dytë i programit njëvjeçar i cili ndjek objektivat në vijim:

- thellimi i ditorisë për skicim, ndërtim dhe vlerësim të godinave që shpenzojnë energji në mënyrë efikase dhe të godinave të gjelbra;
- kualifikimi profesional (baza e kontributit për licencim) për të punuar në fushën e analizës së efikasitetit të energjisë dhe të certifikimit për energji të godinave;
- kualifikimi profesional si bazë të kontributit për provim dhe fitim të titullit Këshilltar LEED-GA.

⁴² Programet mund të mos jenë specializuar vetëm për BER ose EE, por mund të përfshijnë tema të ngjashme në programet e veta.

Fakulteti i Ndërtimtarisë

Cikli i studimeve: Studimet e specializuara akademike

Programi studimor: Efikasiteti energjetik, Mirëmbajtja dhe llogaritja e vlerës së godinave

<http://www.grf.bg.ac.rs/>

Kushti për t'u pranuar në këtë program është që kandidati të ketë kryer studimet akademike të masterit me të paktën 300 kredi (ECTS) në fushën e ndërtimtarisë dhe/ose fusha të ngjashme. Studentët fitojnë kualifikime profesionale për provimin dhe marrin licencë për analizimin e efikasitetit të energjisë, si dhe certifikim për energji të godinave. Veç kësaj, studentët grumbullojnë dituri bazë në fushën e mirëmbajtjes dhe përcaktimin e vlerës së godinave.

Fakulteti i Pylltarisë

Cikli i studimeve: Studimet diplomike dhe master

Programi studimor: Inxhinieria ekologjike për mbrojtje të resurseve të dheut dhe ujërave

<http://www.sfb.bg.ac.rs/>

Në studimet diplomike dhe ato master të "Inxhinierisë ekologjike për mbrojtje të resurseve të dheut dhe ujërave" studentët kualifikohen për menaxhimin e zonave të erozionit, nga aspektet bio-ekologjike, teknike dhe ekonomike.

Kompetenca vijuese fitohet nëpërmjet të këtij programi studimor: kompetenca e plotë për vendet e punës në fushën e inxhinierisë ekologjike, të gjitha vendet e punës në fushën e pyllëzimit, prodhimit të rezervave të mbjelljes për pyllëzim, aplikimit të teknikave dhe teknologjive standarde për mbrojtjen e dheut dhe ujërave, së pari nga erozioni dhe rrjedhja e perruave, vende të punës me shkathtësi të lartë në përmirësimin e ristrukturimit të tokës, dhe ristrukturimin e rrjedhave të ujit të perruave.

UNIVERSITETI I NOVI SADIT

Fakulteti i Bujqësisë

Cikli i studimeve: Studimet diplomike dhe master

Programi studimor: Menaxhimi i ujërave

<http://www.polj.uns.ac.rs/>

Sasitë e zvogëluara të ujit dhe thatësitrat, vërshimet dhe sasitë e tepruara të ujit, ndotja e resurseve të ujit paraqesin çështje jashtëzakonisht të

rëndësishme. Zgjidhje të mundshme të këtyre problemeve lidhur me bujqësinë, ujin dhe ambientin jetësor janë tema interesi të këtij programi studimor.

Fakulteti i Shkencave Teknike

Cikli i studimeve: Studimet diplomike

Programi studimor: Teknologjitë e Energjisë së Pastër

<http://www.ftn.uns.ac.rs/>

Gjatë studimeve katërvjeçare, studentët do të grumbullojnë dituri në energji, shoqëri dhe ambient jetësor, duke llogaritur probabilitetin dhe statistikat, efikasitetin energjetik, sistemet elektrike me kosto të ulët dhe me shpenzim efikas të energjisë, burimet e energjisë elektrike të pastër, planifikimi në inxhinierinë ekologjike.

UNIVERSITETI SHTETËROR I NOVI PAZARIT

Fakulteti i Shkencave Multidisiplinore

Cikli i studimeve: Master

Programi studimor: Shpenzimi Efikas i Energjisë për Godinat

<http://www.np.ac.rs/>

Kompetencat e studentëve të diplomuar

- ekzaminimi i implikimeve kryesore teorike, metodologjike dhe praktike të sistemeve dhe modeleve të ndryshme teorike,
- identifikimi i problemeve në mënyrë të pavarur, përmbledhja e përcaktimi i tyre në mënyrë që mundëson studim shkencor dhe profesional,
- planifikimi, përpilimi dhe zbatimi i hulumtimit në fusha të ndryshme të efikasitetit energjetik,
- themelimi i komunikimit në ekip dhe marrja e rolit organizues dhe udhëheqës në ekip,
- kuptimi dhe aplikimi i diturisë nga fusha e efikasitetit të energjisë, për planifikim dhe intervenim në fusha të ndryshme të teknologjisë,
- kuptimi dhe zbatimi i parimeve të përpilimit, menaxhimit, përpunimit, interpretimit dhe vlerësimit të instrumenteve të duhura të matjes.

Cikli i studimeve: Studime deridiplomike

Programi studimor: Efikasiteti energjetik, ndikimi i energjisë së ripërtërishme dhe i ambientit jetësor

Kompetencat e studentëve të diplomuar

- Kuptimi i implikimeve themelore teorike, metodologjike dhe praktike të sistemeve dhe modeleve të ndryshme teorike,
- identifikimi i problemeve në mënyrë të pavarur, përmbledhja dhe përcaktimi i tyre me hulumtim shkencor dhe profesional,
- planifikimi, përpilimi dhe zbatimi i hulumtimit në fusha të ndryshme të efikasitetit energjetik,
- formulimi preciz i gjetjeve të hulumtimit,
- kuptimi dhe aplikimi i diturisë në fushën e efikasitetit energjetik, për planifikim dhe ndërhyrje në fusha të ndryshme të teknologjisë,
- kuptimi dhe aplikimi i parimeve të disejnit, menaxhimit, përpunimit, interpretimit dhe vlerësimit të instrumenteve të duhura të matjes.

REPUBLIKA E KROACISË

UNIVERSITETI I ZAGREBIT

Cikli i studimeve: Studime Ndërkombëtare Master

Programi studimor: Inxhinieria e Energjisë së Qëndrueshme

<http://www.fsb.unizg.hr/>

Programi zbatohet nga Fakulteti i Termodinamikës, Inxhinierisë Termale dhe Procesore dhe nga Departamenti i Inxhinierisë së Energjisë Elektrike, pranë Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Arkitekturës Detare, Universiteti i Zagrebit, në kuadër të Projektit të Përbashkët Evropian Tempus në bashkëpunim të ngushtë me Institutin Mbretëror të Teknologjisë, Stokholm, Suedi, i cili tanimë ka themeluar me sukses programin ndërkombëtar për Evropën Juglindore, ngjashëm me këtë aktual, si dhe me universitete tjera anëtarë të konzorciumit: Universiteti i Rjekës, Kroaci; Universiteti i Splitit, Kroaci dhe Universiteti i Padovas, Itali.

UNIVERSITETI I SPLITIT

Fakulteti i Ndërtimtarisë, Gjeodezisë dhe Bujqësisë

Cikli i studimeve: Studime Master

Programi studimor: Menaxhimi i Ujërave dhe Inxhinieria e Ambientit Jetësor
<http://www.gradst.unist.hr/>

Programi aftëson inxhinierët që ata të zgjidhin probleme të ambientit jetësor dhe të burimeve ujore, me aplikimin e parimeve nga shkencat natyrore, inxhinieria, ekonomia dhe disiplinat e tjera. Studentëve të ardhshëm do t'u sigurohen bazat e inxhinierisë dhe shkencës, për të qenë në mundësi t'u bëjnë ballë problemeve aktuale dhe të ardhshme të inxhinierisë dhe ambientit jetësor.

UNIVERSITETI I RJEKËS

Fakulteti i Ekonomisë

Cikli i studimeve: Studimet e specializuara akademike

Programi studimor: Ekonomia Energjetike

<http://www.efri.uniri.hr/hr/>

Ky program ofron zhvillimin e aftësive dhe teknikave për krijimin e strategjisë së qëndrueshme afariste; rritjen e efikasitetit të sektorit energjetik; mundësimi i vlerësimit objektiv të suksesit të projekteve energjetike; përmirësimin e cilësisë në dhënien e shërbimeve në sektorin energjetik; dituri të reja mbi financimin e derivateve për çështje tregtie dhe mbrojtja nga rreziku; optimizimi i menaxhmentit financiar; përmirësimi i aftësive të planifikimit të suksesshëm në sektorin energjetik; përshtatja më e shpejtë ndaj standardeve evropiane; zhvillimin e aftësive dhe teknikave për projektet dhe fondet e BE-së; dituri të reja për të ashtuquajturat "sisteme të mençura energjetike" nga strategjitë energjetike të BE-së dhe SHBA-ve; dituri të reja rreth asaj se si të modifikohet funksionimi i metodave të ndërmarrjeve energjetike të rregullimit të sektorit energjetik.

UNIVERSITETI I OSIJEKUT

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

Cikli i studimeve: Studime Master

Programi studimor: Centralet elektrike

<http://www.sfsb.unios.hr/>

Ky program ofron dituri dhe aftësi në hulumtimin, zhvillimin, themelimin dhe aplikimin e metodave dhe mjeteve të reja në projektimin, prodhimin, rindërtimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e centraleve elektrike, efikasitetin e energjisë dhe energjitë e ripërtërishme.

REPUBLIKA E MAQEDONISË

UNIVERSITETI "SHËN KIRILI DHE METODI" – SHKUP, MAQEDONI

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

www.mf.ukim.edu.mk

Cikli i studimeve: Studimet deridiplomike në Shkencën e Inxhinierisë Mekanike

Programi studimor: Inxhinieria e Energjisë dhe Ambientit Jetësor

Ajo që është interesante për këtë studim është se, veç lëndëve teknike, siç janë, "Bazat e Burimeve të Energjisë së Ripërtërishme", "Energjia dhe Ekologjia", "Energjia nga Mbeturinat", etj., ekziston një ndërlidhje me lëndët e menaxhmentit dhe të biznesit, siç janë "Sipërmarrësia dhe Bizneset e Vogla".

Kualifikimi: Master në Shkencën në Inxhinierinë Mekanike

Programi studimor: Inxhinieria e Energjisë dhe Ambienti Jetësor

Në mesin e lëndëve relevante të studimit janë "Optimizimi i sistemeve energjetike", "Menaxhimi i sistemeve energjetike", "Ndërtimi i hidrocentraleve teknike" etj.

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Teknologjitë Informative

www.feit.ukim.edu.mk

Studimet deridiplomike

Kualifikimi: I diplomuar në Shkencën e Inxhinierisë Elektrike

Programi studimor: Inxhinieria e Energjisë dhe Menaxhmenti

Viti i parë është i njëjtë për të gjitha programet dhe ndarja bëhet në vitin e dytë. Ndër lëndët relevante janë "Bazat e inxhinierisë energjetike", "Burimet e energjisë së ripërtërishme", "Hidrocentralet e vogla", "Menaxhimi i projekteve", "Sistemet fotovoltaike" etj.

Kualifikimi: I diplomuar në Shkencën e Inxhinierisë Elektrike

Programi studimor: Sistemet e Elektrocentraleve

Ky program është i ngjashëm me programin "Inxhinieria Energjetike dhe Menaxhmenti" dhe fokusohet më tepër në elektronikën dhe rrjetet elektrike. Ndër temat relevante janë "Sistemet e menaxhimit të energjisë", "Efikasiteti energjetik dhe ambienti jetësor", "Sistemet fotovoltaike" etj.

Studimet master

Kualifikimi: Magjistër i Shkencave të Efikasiteti energjetik, ambientit jetësor dhe zhvillimit të qëndrueshëm

Programi studimor: Efikasiteti energjetik, ambienti jetësor dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Qëllimi i programit studimor është që të sigurojë staf me kompetenca të larta në inxhinieri për hulumtim, zhvillim, përpilim dhe zbatim të projekteve komplekse interdisiplinore në fushat e efikasitetit energjetik, ndikimit të energjisë elektrike dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Kualifikimi: Magjistër i shkencës në Rregullimin në energji, sistemet e komunikimit elektronik dhe rrjetet e transportit

Programi studimor: Rregullimi në energji, komunikime elektronike dhe transport

Ky program ofron dituri mbi nevojat e vendosjes së rregulloreve në fushat lidhur me transportin e mallrave, artikujve, njerëzve apo informacioneve nëpërmjet të sistemeve të mëdha të rrjetit, gjegjësisht, sistemet e gazit, sistemet elektronike të komunikimit dhe rrjetet e transportit.

Fakulteti i Teknologjisë dhe Metalurgjisë

www.tmf.ukim.edu.mk

Studimet master

Diploma: Magjistër i shkencës në inxhinieri ekologjike

Programi studimor: Inxhinieria Ekologjike

Ky studim nuk është shumë i afërt me studimet e energjisë, por studion faktorë shumë të rëndësishëm, të lidhur me sektorin energjetik nëpërmjet temave, siç janë "Ndotja e ajrit", "Industria dhe ambienti jetësor", "Zhvillimi i qëndrueshëm", "Menaxhimi i mbeturinave", "Prodhimtaria e pastër", "Menaxhimi i ambientit jetësor" etj.

UNIVERSITETI "SHËN KLIMENTI I OHRIT" – MANASTIR, MAQEDONI

Fakulteti Teknik

www.tfb.edu.mk

Kualifikimi: I diplomuar në shkencat e energjisë dhe mbrojtjes së ambientit jetësor

Programi studimor: Mbrojtja e energjisë ekologjike

Ky studim trevjeçar ofron lëndë që lidhen ngushtë me energjinë dhe

mbrojtjen e ambientit jetësor, përfshirë këtu dhe lëndë siç janë “Burimet e energjisë së ripërtërishme”, “Inxhinieria mekanike për mbrojtje të ambientit jetësor”, “Energjia dhe energjia e ripërtërishme në zonat rurale” etj.

UNIVERSITETI SHTETËRORË I TETOVËS

www.unite.edu.mk

Instituti i Teknologjisë dhe Ekologjisë

Fakultetet private:

Fakulteti i Ekonomisë së Biznesit – Shkup, Maqedoni

www.fbe.edu.mk

Studimet deridiplomike

Kualifikimi: I diplomuar në shkencën e ekonomisë ekologjike dhe zhvillimit të qëndrueshëm

Programi studimor: Ekonomia ekologjike dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Është ky një program 3-vjeçar, që përfshin aspektet ekonomike dhe të menaxhimit në ambientin jetësor. Ky program paraqet një kombinim të mirë strategjive të biznesit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në kuptimin e ambientit jetësor. Ndër lëndët relevante janë “Shpenzimi efikas i energjisë”, “Politikat ekologjike” etj.

Studimet master

Kualifikimi: Magjistër i shkencës në ekonominë ekologjike dhe zhvillimit të qëndrueshëm

Programi studimor: Ekonomia ekologjike dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Ky program është interesant, pasi kombinon aspektet ekonomike dhe juridike të ambientit jetësor dhe energjisë. Ndër temat relevante janë “E drejta e ambientit jetësor”, “Efikasiteti energjetik”, “Përgjegjësia korporative shoqërore në ambientin jetësor”, etj.

Universiteti MIT - Shkup

Fakulteti i Menaxhimit të Resurseve Ekologjike

www.mit.edu.mk

Nëpërmjet të aplikimit praktik të metodave tona shkencore-hulumtuese, ne së bashku do të vendosim standarde për respektimin e vlerave ekologjike,

do të mësojmë se si të shfrytëzojmë resurset natyrore në mënyrë të qëndrueshme, do të ofrojmë vlerësim efikas të sigurisë ekologjike dhe energjetike, si dhe do të mësojmë për ndryshimet klimatike. Prioritet i këtij programi studimor është t'i mësojmë dhe vendosim standardet e BE-së dhe të aplikojmë vlerat e BE-së lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm dhe natyrën.

***PËR KOSOVËN NUK JANË GJETUR TË DHËNA MBI UNIVERSITETET QË OFROJNË PROGRAME OSE STUDIME MBI BURIMET E ENERGJISË SË RIPËRTËRISHME DHE/OSE EFIKASITETIT ENERGJETIK**

PËR AUTORËT

Antonio Jovanovski është një aktivist i gjelbër që nga viti 2009, kur dhe ka nisur OJQ-në "Go Green" (www.gogreen.mk). Përpara kësaj ka vepruar si aktivist rinor që nga viti 2003, duke mbajtur pozitë drejtuese në AIESEC Maqedoni dhe AIESEC Francë (www.aiesec.org). Për momentin ai është anëtar i Bordit Drejtues të Këshillit Rinor Kombëtar të Maqedonisë (www.nms.org.mk). Antonio ka kryer studimet e marketingut dhe tani përgatit masterin me temë "Ekonomia e ambientit jetësor dhe zhvillimi i qëndrueshëm". Fushat e ekspertizës së tij janë zhvillimi i udhëheqësisë, zhvillimi i fushatave, ndryshimet klimatike, energjia dhe menaxhimi i mbeturinave. Për momentin jeton në Bruksel dhe punon për të Gjëlbrit në Parlamentin Evropian. (www.greens-efa.eu)

E-maili për kontakt: antonio@bidizelen.org

Aleksandar Trpkovski është aktivist rinor që nga viti 2010, kur dhe i është bashkëngjitur rrjetit AIESEC (www.aiesec.org). Brenda degës lokale të AIESEC në Maqedoni, ka mbajtur një numër të caktuar pozitash drejtuese dhe ka qenë në një qëndrim praktik në AIESEC Rusi. Roli i tij aktual përfshin aktivizmin e gjelbër dhe drejtimin e departamentit të rinjve në organizatën ekologjike "Go Green" (www.gogreen.mk). Aleksandri ka kryer studimet e shkencave politike dhe aktualisht ndjek studimet e masterit mbi "Institucionet dhe politikat evropiane" në Fakultetin Juridik "Justinian I" në Shkup.

E-maili për kontakt: aleksandar@bidizelen.org

